



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 22/2024 regjistër (JR)
Datë 07.06.2024

Nr. 69 i vendimit
Datë 01.10.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjyqësor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Ina Rama	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më 01.10.2025, ditën e mërkurë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier De Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Griselda Muça, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Milan Laskaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 748, datë 27.03.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 179/b, paragrafi 5; neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shqyrtoi pretendimet e kërkesave të subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 748, datë 27.03.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes, Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Milan Laskaj (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex-officio*, për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”).
2. Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka zhvilluar hetimin administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit, përkatësisht për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Në zbatim të përcaktimeve të neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), sipas neneve 31-33 të ligjit nr. 84/2016, nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar¹ (në vijim “AKSIK”), sipas neneve 34-39 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), sipas neneve 40-44 të po këtij ligji.

2.1. ILDKPKI-ja, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për pasurinë, i ka dërguar Komisionit raport-kontrollin², ku konkludohet se: *Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja konstaton për subjektin e rivlerësimit Milan Laskaj, si vijon:*

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2. AKSIK-u ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës

¹ Ish-Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK).

² Me shkresën nr. {***} prot., datë 30.03.2018.

dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar një raport³ për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Sipas këtij raporti, grupi i punës ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

2.3. KLP-ja ka hartuar raportin⁴ për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, të cilin ia ka përcjellë Komisionit.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Me vendimin 748, datë 27.03.2024, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vendosur: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Milan Laskaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.*
4. Vendimmarrja e Komisionit për subjektin e rivlerësimit Milan Laskaj është bazuar në përfundimet e arritura në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, si dhe në vlerësimin tërësor të rrethanave dhe procedurave që kanë lidhje me këtë kriter dhe me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, të cilat kanë pasjellë aplikimin e nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Komisioni e ka mbështetur vendimin e tij në konkluzionet e mëposhtme.

4.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

Mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimit, si dhe provat shkresore të administruara në dosje lidhur me kriterin e vlerësimit pasuror, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit: (i) ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë; (ii) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) ka kryer fshehje të pasurisë, duke u vendosur në kushtet e parashikuara sipas leximit a contrario të nenit 33, pika 5, shkronja "a" e ligjit nr. 84/2016, si dhe në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronjat "b" dhe "c" të ligjit nr. 84/2016, çka përbën shkak për shkarkimin e tij nga detyra në përputhje me pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

4.2. Për kriterin e kontrollit të figurës:

Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetin e subjektit të rivlerësimit, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Milan Laskaj ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës "b" të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

³ Me shkresën nr. {***} prot., datë 06.07.2023, AKSIK-ja ka përcjellë raportin me nr. {***} prot., datë 02.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin a KDZh-së nr. {***}, datë 04.07.2023.

⁴ Me nr. {***} prot., datë 23.05.2023.

4.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:

Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje procedurale, gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektivitetit të rivlerësimit, gjë që mund të çonte në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale.

Për kontrollin e kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, trupi gjykues, në bazë të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, konkluzionet lidhur me çështjet dhe denoncimet e shqyrtuara në kuadër të këtij gjykimi nuk i konsideroi të mjaftueshme për të konkluduar në bazë të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

4.4. Për vlerësimin tërësor:

Në vlerësimin tërësor të çështjes, bazuar në nenin 4, pika 2 dhe nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, pasi: (i) u konkludua se ai ka pasur pasuri të fshehur, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016; (ii) në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë ka dështuar të krijojë seksionet, të organizojë dhe dokumentojë shpërndarjen e çështjeve të regjistruara në këtë prokurori, bazuar në kriteret objektive dhe transparente, si dhe të sigurojë përdorimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve, në përputhje me parashikimet e neneve 21 dhe 42, shkronjat “c” dhe “h” të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe pikës 2, kreu II i udhëzimit nr. 3, datë 29.12.2016, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”; (iii) ka cenuar pavarësinë e prokurorit të çështjes, në kundërshtim me parashikimet e bëra në nenin 6 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

III. Ankimi kundër vendimit të Komisionit

5. Kundër vendimit të Komisionit nr. 748, datë 27.03.2024, ka paraqitur ankim subjekti i rivlerësimit Milan Laskaj, nëpërmjet të cilit ka ngritur pretendime me të cilat kundërshton konkluzionet e Komisionit për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe vlerësimin tërësor, duke kërkuar nga trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “trupi gjykues”), ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin e tij në detyrë.

A. Shkaqe ankimi që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

6. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit si të pabazuar në ligj dhe në jurisprudencën e Kolegjit, lidhur me pasurinë e tij të paluajtshme të llojit apartament, të ndodhur në {***} ({***}), Tiranë, me sip. 91,4 m², të blerë me çmimin 38.000 euro ,nga shoqëria “{***}” ShPK, me kontratën e porosisë së datës 19.02.2011, si vijon.

6.1. Lidhur me mosdeklarimin e saktë të burimit të krijimit të shumës së përdorur për pagesën e këstit të parë të çmimit të këtij apartamenti, për shkak se:

- i) Komisioni në mënyrë të padrejtë nuk ka konsideruar si burim financimi kontratën e kaparit në shumën 10.000 euro të paguar nga subjekti shoqërisë “{***}” ShPK, për një apartament tjetër me sip. 78,9 m²;
- ii) nuk ka pranuar realizimin e pagesës së pjesshme të kaparit prej 500.000 lekësh në fund të vitit 2009, pagesë e cila është e provuar me mandatpagesa të kohës;
- iii) Komisioni nuk i ka dhënë vlerë provuese deklarimeve e shpjegimeve të dhëna nga subjekti në ILDKPKI përpara miratimit të ligjit nr. 84/2016.

6.2. Lidhur me burimet e financimit të apartamentit pretendon se:

- i) nuk ka pasur detyrim për të deklaruar në deklaratimet periodike të pasurisë huat e marra për pagesën e kaparit dhe të këstit të dytë të apartamentit në kushtet kur ato janë marrë dhe shlyer brenda të njëjtit vit kalendarik, qëndrim i cili, sipas tij, është konfirmuar nga jurisprudenca e vetë Komisionit;
- ii) Komisioni në mënyrë të padrejtë dhe në kundërshtim me jurisprudencën nuk ka konsideruar si burim financimi huat e marra nga subjekti prej shtetasit P. H. dhe të shlyer brenda vitit 2010, si dhe nga shtetasja Z. B., të shlyer brenda vitit 2011, vlera që në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, provohet se nga huadhënësit janë krijuar me burime të ligjshme dhe se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme për kthimin e tyre;
- iii) në analizën financiare për pagesën e këstit të parë të apartamentit (pagesë e pjesshme kapari në vitin 2009-2010), nuk janë përfshirë si të ardhura likuiditetet *cash* që ka disponuar për shkak të pagesave të dietave të akumuluar nga punëdhënësi;
- iv) konkluzioni i Komisionit se huadhënësi I. M., në kuptim të përcaktimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk arriti të provonte se kishte burime të ligjshme për të krijuar shumën e dhënë hua subjektit në vlerën 5.000 euro, nuk është i bazuar në situatën faktike dhe, për rrjedhojë, nuk është i drejtë.

- 7. Subjekti i rivlerësimit kundërshton si të pabazuar në ligj dhe në prova dhe të padrejtë konkluzionin e Komisionit, referuar gjendjes së kursimeve *cash* të disponuara prej tij dhe bashkëshortes në datën e dorëzimit të deklaratës *vetting* më 26.01.2017.
- 8. Subjekti i rivlerësimit kundërshton si të padrejtë konkluzionin e Komisionit se automjeti, me targa {***}, është pasuri e fshehur e tij, i marrë për shkak të analizimit të gabuar të situatës faktike dhe të provave, i cili, gjithashtu, vjen në kundërshtim me jurisprudencën e Kolegjit.
- 9. Subjekti i rivlerësimit kërkon rishikimin e analizës financiare tërësore të Komisionit për periudhës 2003-2016, pasi e konsideron atë të pasaktë dhe jo të drejtë.

B. Shkaqe ankimi që lidhen me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe cenimin e besimit të publikut

- 10. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale duke pretenduar se:

- i) Analiza që Komisioni ka bërë për veprimtarinë e tij si drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë nuk është e drejtë, pasi është bërë vlerësim i gabuar i provave, situatës faktike e ligjore. Për rrjedhojë, subjekti pretendon se janë të pabazuar në prova dhe ligj konkluzionet e Komisionit se:
 - a) subjekti ka dështuar në krijimin e një seksioni të ri në zyrën e prokurorisë që ai drejtonte, dhe se nuk ka marrë masa lidhur me mosfunksionimin e shortit elektronik;
 - b) subjekti, duke përpiluar dy urdhra për kthimin e sendeve të sekuestruara në kuadër të një procedimi penal, i cili nuk ndiqej prej tij, ka cenuar pavarësinë e prokurorit të çështjes.
 - ii) Vlerësimi i performancës së punës së tij si Drejtues i Prokurorisë Lezhë, duhet të jetë pa ndikim në procesin e tij të rivlerësimit, për sa kohë vetë Komisioni ka konkluduar se ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuara nga ligji nr. 84/2016.
11. Subjekti i rivlerësimit kundërshton si tërësisht të paargumentuar dhe të pabazuar ligjërisht konkluzionin e Komisionit se në vlerësimin tërësor të çështjes ai ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

12. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) për gjykimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit që ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Milan Laskaj, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

13. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma e gjykimit

14. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si rregull, shqyrtimi i ankimit, në rastin kur vendimi i Komisionit ankohet nga subjekti i rivlerësimit, kryhet në dhomë këshillimi. Subjekti i rivlerësimit Milan Laskaj ka kërkuar, në ankim, që çështja e tij të gjykohet në seancë gjyqësore

publike me qëllim *shqyrtimin në themel të fakteve dhe provave duke administruar provat e reja*, dhe duke vendosur: *Ndryshimin e vendimit nr. 748, datë 27.03.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Milan Laskaj, në funksionin prokuror në Prokurorisë pranë Gjykatë së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë*

14.1. Trupi gjykues konstaton se me ankimin subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji të administrohen në cilësinë e provës së re disa akte që i janë bashkëlidhur atij, si vijon:

- i) shkresë nr. {***} prot., datë 26.03.2024, e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
- ii) akti i vlerësimit të tokës bujqësore i përgatitur nga ing. Xh. B., më datë 16.02.2024, lidhur me të ardhurat që mund të përfitohen nga përdorimi/mbjellja e parcelave tokë arë⁵.

14.2. Nga shqyrtimi i informacionit që përmbajnë aktet e evidentuara më sipër, konstatohet se:

- i) shkresa nr. {***} prot., datë 26.03.2024, e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, synon provimin e faktit se prokurorja R. F., gjendej jashtë vendit në momentin kur subjekti në procedimin penal nr. {***}/2020, që ndiqej nga kjo prokurorë për veprën penale “drejtimi i mjetit në mënyrë të parregullt” (pa leje drejtimi), ka nxjerrë urdhër për kthimin e mjetit të sekuestruar në cilësinë e provës materiale;
- ii) akti i vlerësimit të tokës bujqësore, i përgatitur nga ing. Xh. B., më datë 16.02.2024, synon të provojë se huadhënësi I. M. ka pasur të ardhura të ligjshme të siguruara nga tokat bujqësore për të dhëne hua shumë 5.000 euro subjektit të rivlerësimit.

14.3. Trupi gjykues, lidhur me kërkesën e subjektit për marrjen e provave të reja, në kuptim të përcaktimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, konstaton se: *Së pari*, në ankim, subjekti nuk ka paraqitur asnjë shpjegim se përse këto akte nuk janë paraqitur prej tij në Komision, në kushtet kur me rezultatet e hetimit, subjekti ka pasur dijeni për gjetjet e Komisionit, të cilat synohen të shërohen prej këtyre akteve. *Së dyti*, në kushtet kur konstatohet se subjekti gjatë hetimit administrativ i ka bërë prezent Komisionit faktin se prokurorja R. F., në momentin kur subjekti ka nxjerrë urdhër për kthimin e automjetit gjendej jashtë vendit, e dhënë e cila nuk është kontestuar nga Komisioni, dhe se nëse Kolegji e vlerëson të nevojshme verifikimin e saj, ka të gjitha mundësitë për të aksesuar drejtpërdrejtë informacionin në sistemin *TIMS*, vlerësohet se nuk është e nevojshme marrja në cilësinë e provës të shkresës nr. {***} prot., datë 26.03.2024, e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. *Së treti*, duke iu referuar të dhënave të aktit të vlerësimit të tokave bujqësore të përgatitur nga ing. Xh. B., më datë 16.02.2024, edhe në versionin që mund të pranohet se ky akt plotëson kushtet për t’u administruar si provë, siç analizohet në pjesën vijuese të këtij vendimi, për shkak se të dhënat që ai ofron nuk mbështeten në akte të kohës kur pretendohet se janë krijuar të ardhurat, ai nuk mund të ketë vlerë provuese për faktet që kërkohen të provohen.

14.4. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se për shkak të situatës faktike dhe ligjore të analizuar më sipër, kërkesa e subjektit nuk gjendet e mbështetur në nenin 47 i ligjit nr. 49/2012, si edhe provat e paraqitura konsiderohen të panevojshme për zgjidhjen e çështjes, edhe sipas një vlerësim

⁵ Me sip. 473 m² dhe 1700 m² dhe 3.200 m², me vendndodhje në fshatin {***} të Njesisë Administrative {***}, Tropojë, në pronësi të shtetasit I. M.; me sip. 5.350 m², me vendndodhje në fshatin {***}, të Njesisë Administrative {***}, Tropojë, në pronësi të shtetasit A. M.

të përcaktimeve të neneve 45 dhe 49, pika 6, shkronja “a” të ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, në kushtet kur edhe nuk u konstatua asnjë prej situatave të parashikuara nga neni 51 i ligjit nr. 49/2012, që do të diktonte shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, trupi gjykues vijoi me shqyrtimin e saj në dhomë këshillimi, bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ në Komision, në përputhje me nenin 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit nga trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

i. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

15. Trupi gjykues mori në shqyrtim dhe ia nënshtroi analizës shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë, të cilat subjekti i rivlerësimi i ka identifikuar si arsye për të cilat duhet të vendoset ndryshimi i vendimit të Komisionit dhe konfirmimi i tij në detyrë.

15.1. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si shkaqe ankimi lidhur me konkluzionet e Komisionit për pasurinë e tij të paluajtshme, të llojit apartament të ndodhur në {***} ({***}) Tiranë, me sip. 91,4 m², të blerë me çmimin 38.000 euro nga shoqëria “{***}” ShPK, me kontratën e porosisë së datës 19.02.2011, sipas përshkrimit të bërë në pjesën hyrëse të këtij vendimi, të cilat i janë nënshtuar analizës së trupi gjykues në vijim të këtij arsyetimi.

15.2. Në funksion të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit, trupi gjykues vlerëson të evidentojë fillimisht qëndrimin e Komisionit lidhur me këtë pasuri të subjektit, sipas së cilin është analizuar dhe konkluduar si vijon.

15.1.1. Komisioni ka kontrolluar fillimisht vërtetësinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit të kryera në deklaratën *vetting*, lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie, duke konkluduar se për shkak të mosdeklarimit të huave të përkohshme, të marra dhe shlyera brenda vitit korrent, si burime të krijimit të pasurisë prej subjektit nga shtetasit P. H. dhe Z. B., si dhe mosdeklarimin e vlerës së kaparit të paguar për një tjetër pasuri, si burim krijimin në deklaratën *vetting*, subjekti gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe, si pasojë, Komisioni nuk ka njohur këto burime si të përdorshme për financimin e pasurisë objekt kontrolli. Në përfundim, Komisioni, pasi ka analizuar secilin prej burimeve, ato të deklaruara edhe ato të cilët nuk janë deklaruar, si dhe ka verifikuar mundësinë për krijimin me të ardhura të ligjshme të burimeve të njohura, ka arritur në përfundimin se: *Si konkluzion, në vlerësimin tërësor të kësaj pasurie, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të kësaj pasurie, në kundërshtim me parashikimet e bëra në nenin 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, si dhe nuk ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për krijimin e saj, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.*

15.1.2. Nga aktet e administruara në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues konstaton se lidhur me këtë pasuri gjenden një sërë deklaramesh të subjektit në deklaratat për deklarimin e pasurisë, pranë ILDKPKI-së, si dhe gjatë hetimit administrativ në Komision, të cilat evidentohen si vijon në funksion të pasqyrit të situatës faktike, para se të analizohen shkaqet e ankimit lidhur me konkluzionin e Komisionit, në raport me këtë pasuri.

15.1.3. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar: *Apartament⁶ me sip. 91,4 m² prenotuar nga shoqëria “{***}” ShPK, me kontratën e porosisë së datës 19.02.2011, ndodhur në rrugën “{***}”, lagjja {***}, Njësia Administrative {***}, me vlerë 38.000 euro, paguar shuma prej 36.000 eurosh. Burimi i krijimi: a) të ardhurat e tij si prokuror; b) kredi në Bankën Credins në shumën 800.000 lekë me afat 4 vjet marrë më datë 29.07.2011; c) 200.000 lekë overdraft (kredia dhe overdraftin janë shlyer tërësisht me të ardhurat nga paga e subjektit).*

15.1.4. Në deklaratat periodike vjetore të pasurisë në vite (në vijim “DVP”), lidhur me këtë pasuri, subjekti ka deklaruar:

i) Në DVP-në 2010, subjekti ka deklaruar se ka lidhur një kontratë kapari për blerjen e një apartamenti banimi me sip. 79,4 m², me vlerë 32.000 euro, ndodhur në lagjen {***}, Komuna {***}, apartament për të cilin ka paguar shumën prej 10.000 eurosh dhe ka ngelur si detyrim shuma prej 22.000 eurosh. Burimi i krijimit për pagesën e kryer në shumën prej 10.000 eurosh kanë qenë të ardhurat e tij vjetore nga pagat dhe dietat e marra gjatë punës si prokuror.

ii) Në DVP-në 2011, subjekti ka deklaruar se në datën 19.02.2011, ka lidhur kontratë porosie me shoqërinë “{***}” ShPK., për blerjen e një apartamenti banimi me sip. 91,4 m², me vlerë 38.000 euro, ndodhur në lagjen {***}, Komuna {***}. Subjekti ka deklaruar se ka paguar shumën prej 30.000 eurosh dhe i ka ngelur si detyrim shuma prej 8.000 eurosh. Si burim për kryerjen e kësaj pagese kanë qenë: (a) të ardhurat vjetore nga pagat dhe dietat e marra gjatë punës si prokuror; (b) kredia në shumën prej 800.000 lekësh; (c) overdraft në shumën prej 200.000 lekësh. Gjithashtu, ka deklaruar se ka marrë hua pa interes: (a) në datën 12.01.2011, shumën prej 5.000 eurosh nga shtetasi I. M.; (b) në datën 20.01.2011, shumën prej 5.000 eurosh nga shtetasi N. L.

iii) Në DVP-në 2012, krahas shlyerjes së kredisë në Credins Bank, subjekti deklaroi se i ka shlyer 2.000 euro shtetasit I. M., nga shuma e marrë hua në vitin 2011 prej 5.000 eurosh.

iv) Në DVP-në 2013, krahas shlyerjes së kredisë në Credins Bank, subjekti deklaroi se ka i shlyer 2.000 euro shtetasit I. M., si dhe duke deklaruar detyrimin e mbetur prej 1.000 eurosh.

v) Në DVP-në 2014, krahas shlyerjes së kredisë në Credins Bank, subjekti deklaroi se i ka shlyer 1.000 euro shtetasit I. M. dhe 3.000 euro shtetasit N. L., si dhe duke deklaruar detyrimin e mbetur këtij të fundit prej 2.000 eurosh.

vi) Në DVP-në 2015, krahas shlyerjes së kredisë në Credins Bank, subjekti deklaroi se i ka shlyer detyrimin e mbetur ndaj shtetasit N. L., në shumën prej 2.000 eurosh.

vii) Në DVP-në 2016, në seksionin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti ka deklaruar se i ka paguar shoqërisë “{***}” ShPK., shumën prej 6.000 eurosh, me burim të ardhurat nga paga, si edhe kursimet e vitit 2015, në shumën prej 300.000 lekësh.

⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit kalimtar *vetting* (aneks 4/1 në dosjen e ILDKPKI-së) dokumentet: (i) kontratë porosie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.02.2011; (ii) leje ndërtimi nr. {***}, datë 30.12.2009, lëshuar nga Komuna Dajt për godinë banimi dhe shërbimi 5 kat + papafingo + 1 kat parkim për shoqërinë “{***}” ShPK., + praktika e shoqërisë “{***}” ShPK.; dhe (iii) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.01.2017.

15.1.5. Në ILDKPKI, më datë 19.01.2016, subjekti ka deklaruar se burimi i shumës prej 10.000 eurosh, të dhënë si kapar në vitin 2010, ka qenë nga të ardhurat nga pagat dhe dietat për vitin 2010 dhe ka deklaruar se po paraqet edhe vërtetimin për të ardhurat në vitin 2009, në shumën 1.485.230 lekë. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se ka qenë i komanduar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan në shtator 2009 dhe për një periudhë kohe është trajtuar me dieta. Ndër të tjera, subjekti ka deklaruar se në datën 19.02.2011 ka revokuar kontratën e kaparit për apartamentin me sip. 78,9 m² (deklaruar në DVP-në 2010), duke i kthyer palët në gjendjen e mëparshme dhe shumën prej 10.000 eurosh, të paguar si kapar në vitin 2010, e ka konsideruar të llogaritur në vlerën prej 30.000 eurosh të paguar ndaj palës së porositur më 19.02.2011, për apartamentin e ri.

15.1.6. Në Komision, gjatë hetimit administrativ, subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, ka deklaruar se në maj të vitit 2010 ka marrë hua nga shtetasi P. H. shumën prej 3.000 eurosh, shumë të cilën e ka likuiduar brenda muajit korrik të vitit 2010, për justifikimin e së cilës ka depozituar në Komisionin deklaraten noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.02.2021, të huadhënësit. Po në përgjigje të këtij pyetësori, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në janar të vitit 2011 ka marrë hua nga shtetasja Z. B. shumën prej 10.000 eurosh, referuar si e likuiduar brenda vitit 2011. Në mbështetje të këtij deklarami, subjekti ka depozituar deklaraten noteriale të kësaj shtetase të datës 02.02.2021, sipas së cilës, krahas deklaramit të dhënies dhe marrjes së kësaj shume, referohet se qëllimi i dhënies ka qenë për blerje apartamenti banimi.

15.2. Trupi gjykues, në funksion të shqyrtimit të pretendimit të subjektit se *Komisioni në mënyrë të padrejtë nuk ka konsideruar si burim financimi kontratën e kaparit në shumën 10.000 euro të paguar nga subjekti shoqërisë “{***}” ShPK, për një apartament tjetër me sip. 78,9 m²*, mori në analizë faktet e rezultuara gjatë hetimit lidhur me këtë çështje, përveç atyre të referuara më lart, të cilat lidhen përgjithësisht me të gjitha shkaqet e ankimit të subjektit. Nga verifikimi i dokumentacionit⁷ të administruar në fashikullin e Komisionit, lidhur me apartamentin në {***}, {***}, konstatohen të dhënat si vijon:

15.2.1. Në datën 26.05.2010, është nënshkruar një kontratë noteriale e kaparit⁸ me nr. {***} rep., nr. {***} kol., në të cilën përcaktohet se kaparmarrësi (shoqëria) kërkon t’i shesë kapardhënësit (subjektit të rivlerësimit) pasurinë e llojit apartament banimi me sip. 78,9 m², në objektin që po ndërtohej nga shoqëria “{***}” ShPK, të ndodhur në {***}, Komuna {***}, për të cilin si kapar i është dhënë shuma prej 10.000 eurosh, shumë e cila deklarohet e dhënë dhe e marrë respektivisht nga palët, ndërsa për diferencën tjetër që mbetet, palët përcaktojnë se do të paguhet kur

⁷ (i) dokumentacioni i depozituar nga subjekti me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar vetting, ndodhur Aneks 4/1 në dosjen e ILDKPKI-së; (ii) dokumentacioni i përcjellë me shkresën e ILDKPKI-së nr. {***} prot., datë 11.10.2023 (protokolluar në KPK me nr. {***} prot., datë 13.10.2023); (iii) dokumentacioni i administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ prej Zyrrave Noteriale; dhe (iv) dokumentacioni i depozituar nga subjekti gjatë hetimit administrativ.

⁸ Kontratë kapari me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.05.2010, në të cilën nuk është përcaktuar çmimi total i kësaj pasurie. Ndërkohë, në DIPP-në 2010, duke iu referuar kësaj kontrate, subjekti e deklaroi me vlerë 32.000 euro. Kontrata e kaparit, thotë, [...] Milan Laskaj deklaroi se i dha në dorë kaparmarrësit S. D. shumën prej 10.000 eurosh, shumë të cilën pala D. deklaroi se e mori tërësisht në dorë dhe nuk ka asnjë pretendim tjetër për të [...].

kaparmarrësi do të ndërtojë apartamentin e banimit dhe do të nxjerrë dokumentet nga ZVRPP-ja dhe, më pas, do bëhet akti përfundimtar i shitjes në favor të kapardhënesit.

15.2.2. Në datën 19.02.2011, nëpërmjet aktit noterial nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., subjekti i rivlerësimit dhe shtetasi S. D., përfaqësuesi ligjor i shoqërisë “{***}” ShPK, revokojnë kontratën e kaparit të datës 26.05.2010, duke deklaruar se palët kthehen në gjendjen e mëparshme.

Po më datë 19.02.2011, subjekti i rivlerësimit në cilësinë e porositësit dhe shoqëria “{***}” ShPK, me përfaqësues ligjor shtetasin S. D., në cilësinë e sipërmarrësit, nënshkruajnë kontratën e porosisë⁹, me objekt porositjen e një apartamenti banimi me sip. 91,4 m², me çmim 38.000 euro, në objektin 5 kat + papafingo + 1 kat parkim, në Komunën {***}, me plan pagesash: 30.000 euro (kësti i parë), paguar në momentin e nënshkrimit të kontratës; 7.000 euro do të paguhen në momentin e dorëzimit të apartamentit; dhe 1.000 euro në momentin e dorëzimit të hipotekës.

15.3. Pavarësisht sa më sipër, rezulton se Komisioni nuk ka konsideruar si burim financimi pagesën e pretenduar si të kryer nga subjekti prej 10.000 eurosh, që rrjedh nga revokimi i kontratës së kaparit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.05.2010, të lidhur ndërmjet subjektit dhe shoqërisë “{***}” ShPK, për një apartament tjetër me sip. 78,9 m², bazuar në argumentet se: (i) në deklaratën *vetting*, subjekti nuk ka deklaruar asgjë lidhur me këtë kontratë kapari si burim financimi i apartamentit; (ii) në DVP-në 2011, kur subjekti ka deklaruar lidhjen e një kontrate tjetër porosie për blerjen e një apartamentit me sip. 91,4 m², objekt kontrolli, me po të njëjtën shoqëri dhe vendndodhje në të njëjtën godinë, nuk ka deklaruar se si pjesë e pagesës së kështit të parë të ketë shërbyer dhe shuma e paguar dhe e kthyer për kontratën e kaparit, të një tjetër apartamenti të porositur më parë.

15.4. Trupi gjykues verifikoi, *së pari*, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me burimet e krijimit të pasurisë objekt kontrolli dhe arriti në konkluzionin e njëjtë me Komisionin se subjekti ka deklaruar në mënyrë të pasaktë burimet e krijimit të kësaj pasurie në deklaratën *vetting*, duke mosdeklaruar ato në mënyrë të plotë e të qartë, situatë që e vendos atë në kushtet e një deklarimi të pasaktë, sipas leximit *a contrario* të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. *Së dyti*, pavarësisht pasaktësive në deklaram, trupi gjykues analizoi të dhënat që rezultojnë nga aktet, kontratat noteriale të administruara në hetim, që ndonëse nuk janë bërë pjesë e deklarimeve të subjektit në mënyrën e duhur në deklaratën *vetting*, provojnë disa fakte juridike që kanë ndodhur e janë deklaruar edhe prej subjektit në DVP-të, të cilat duhen konsideruar në drejtim të kontrollit të ligjshmërisë së burimeve të përdorua për financimin e pasurisë së subjektit, sipas së cilave konstatohet se: (i) marrëdhënia e kaparit e subjektit me shoqërinë “{***}” ShPK ka qenë e përcaktuar në një kontratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.05.2010, e cila duket se ka shërbyer për pagimin nga subjekti të shumës 10.000 euro, për blerjen e një apartamenti të prenotuar më parë me sip. 78,9 m²; (ii) pasi subjekti dhe shoqëria kanë vendosur të revokojnë marrëdhënien e porosisë për apartamentin e porositur prej 78,9 m², për të lidhur një marrëdhënie të re për porositjen e apartamentit objekt kontrolli, është revokuar edhe marrëdhënia e kaparit, duke i kthyer palët në gjendjen e mëparshme, me anë të kontratës noteriale me nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 19.02.2011, e cila ka përcaktuar se nga kontrata e kaparit nr. {***}/ {***},

⁹ Kontratë porosie me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.02.2011.

datë 26.05.2010, *Milan Laskaj i ka paguar z. S. D. shumën 10.000 euro dhe se palët vendosin të mos e përfundojnë këtë marrëdhënie juridiko-civile për arsye objektive [...] se palët kthehen në gjendjen e mëparshme dhe se apartamenti i sipërcituar (me sip. 78,9 m²) është i lirë për t'u shitur nga z. S. D.*

15.5. Nga këto të dhëna të aspektit financiar, duket se pas nënshkrimit të revokimit të kontratës noteriale të kaparit më datë 19.02.2011, subjekti, si rregull, duhet të ketë marrë mbrapsht, potencialisht ose është kompensuar *de jure*, nga përfaqësuesi i shoqërisë “{***}” ShPK, shumën 10.000 euro të paguar për llogari të kontratës së kaparit, që po revokohej me marrëveshje të palëve. Në kushtet kur evidentohet se palët në mënyrë të njëpasnjëshme¹⁰ kanë proceduar fillimisht, duke revokuar kontratën e kaparit dhe menjëherë, në të njëjtën ditë, kanë vijuar me lidhjen e kontratës së porosisë për një apartament tjetër me sipërfaqe më të madhe prej 91,4 m², duket i arsyeshëm dhe bindës pretendimi i subjektit se kapari si pagesë e kryer tashmë për një apartament që nuk do të përfitohej më prej tij, ka shkuar/është transferuar si pagesë për çmimin e apartamentit tjetër, nëpërmjet shlyerjes së detyrimeve mes palëve me kompensim. Në vlerësimin e trupit gjykues, këto të dhëna dëshmojnë se palët në aspektin financiar kanë vijuar të jenë në një marrëdhënie të pandërprerë me njëri-tjetrin, dhe se kjo situatë duket se ka ndikuar në mos specifikimin në deklaratimet e pasurisë se shuma 10.000 euro e paguar për apartamentin me sip. 78,9 m² ka shkuar si pagesë për apartamentin tjetër me sip. 91,4 m².

15.6. Trupi gjykues, duke vijuar analizën, konstaton se në nenin 2 të kontratës noteriale të revokimit të kaparit përcaktohet se *palët kthehen në gjendjen e mëparshme [...] dhe po e njëjta dispozitë vijon duke evidentuar se apartamenti i sipërcituar i cili ka qenë objekt shetje i kontratës së kaparit mbetet i lirë për t'u shitur nga ana e z. S. D.* Nisur nga këto përcaktime të kontratës së revokimit të kaparit, rezulton se si qëllim kryesor ky akt noterial ka pasur mundësimin/mospengimin e përfaqësuesve të shoqërisë “{***}” ShPK, për të shitur apartamentin me sip. 78,9 m², të një palë tjetër që nuk është subjekti i rivlerësimit, pasi siç u evidentua më sipër, me subjektin shoqëria “{***}” ShPK, ka vijuar marrëdhënien duke nënshkruar menjëherë një kontratë tjetër porosie për një apartament me sipërfaqe më të madhe.

15.7. Gjithashtu, rezulton se në procesverbalin e mbajtur më datë 19.01.2016 në ILDKPKI, në përgjigje të pyetjes nëse subjekti e disponon kontratën e kaparit, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se: *[...] Po ju paraqes kopje “kontratë kapari” lidhur më datë 26.05.2010, e cila është revokuar sipas dokumentit noterial “Revokim Kontratës Kaparit” lidhur më 19.02.2011. Këtë apartament banimi e kam shkëmbyer me një apartament tjetër në të njëjtin pallat.*

Në vlerësimin e trupit gjykues, këto deklaratime të subjektit, të bëra në kohë para miratimit të ligjit nr. 84/2016, duket se japin informacionin se veprimet që ai ka kryer me shoqërinë “{***}” ShPK, edhe pse nuk përmbushin kushtet për t'u konsideruar si një marrëdhënie shkëmbimi, sipas përcaktimeve të Kodit Civil (nenet 757, 758 e 759), tregojnë se subjekti me këtë shoqëri ndërtimi ka pasur marrëdhënie të pandërprera e vijuese, e cila ka ndryshuar vetëm objektin konkret të

¹⁰ Fakt i cili provohet si nga elementi se revokimi i kaparit dhe lidhja e kontratës së porosisë së apartamentit me sip. 91,4 m² janë bërë po më datë 19.02.2011, por edhe nga fakti se këto veprime janë pasqyruar në akte noteriale me numra të njëpasnjëshëm të repertorit dhe koleksionit (revokimi i kaparit ka nr. {***} rep., e nr. {***} kol., ndërsa kontrata e porosisë ka nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol.).

porosisë, por jo natyrën e marrëdhënies. Referuar në sa më sipër, përtej diskutimit/analizës nëse subjekti ka pasur ose jo burime të ligjshme për pagesën e kaparit në vitin 2010 (çështje e cila gjen trajtim në vijim), vijueshmërinë e marrëdhënies që subjekti ka pasur me shoqërinë “{***}” ShPK, trupi gjykues e konsideron si një fakt përcaktues për të mbështetur në mënyrë logjike shpjegimet/pretendimet e subjektit se, pagesa e kaparit për apartamentin e parë, pas revokimit të kësaj marrëdhënie, ka shkuar si pagesë për apartamentin tjetër të porositur tek e njëjta shoqëri e që ndodhet në të njëjtin objekt me të parin.

15.8. Në këtë kuptim, trupi gjykues e gjen të drejtë pretendimin e subjektit se një nga burimet me të cilat ai ka financuar pagesën e këstit të parë të apartamentit ka qenë edhe shuma prej 10.000 eurosh, e parapaguar prej tij si kapar në vitin 2010 për një apartament tjetër, por që ka shkuar për financimin e apartamentit të ri, objekt kontrolli, pavarësisht se kjo situatë nuk ka gjetur pasqyrim të plotë shpjegues në deklaratën *vetting*. I gjithë ky transaksion, gjendet jo vetëm i deklaruar në DVP-në 2010, por edhe në kontratat noteriale të kohës, qoftë lidhja e kaparit qoftë revokimi, duke përjashtuar çdo dyshim për ekzistencën e tij. Për pasojë, trupi gjykues do të vijojë në analizën e tij me kontrollin e mundësisë së subjektit për krijimin me burime të ligjshme të shumës prej 10.000 eurosh të paguara si kapar në vitin 2010.

15.9. Në lidhje me shqyrtimin e pretendimit të subjektit që lidhet me metodologjinë e pagesës së kaparit sipas së cilit, *Komisioni padrejtësisht nuk ka pranuar realizimin e pagesës së pjesshme të kaparit prej 500.000 lekësh në fund të vitit 2009, pagesë e cila është e provuar me mandatpagesa të kohës*, trupi gjykues analizon sa vijon.

15.10. Në vendimin e Komisionit lidhur me burimin e financimit të kaparit, nuk ka pranuar si të besueshme pretendimet e subjektit se kapari është paguar në dy pjesë, një vlerë prej 500.000 lekësh në vitin 2009 dhe diferenca prej 6.400 eurosh në kohën e lidhjes së kontratës, për shkak se ky fakt nuk gjen pasqyrim as në kontratën e kaparit të nënshkruar në datën 26.05.2020, dhe as në DVP-në 2010, në të cilën deklarohet kjo marrëveshje, madje as në procesverbalin e datës 19.01.2016, të mbajtur në ILDKPKI, në të cilin subjektit i janë drejtuar pyetje rreth kësaj kontrate. Në përfundim të hetimit, Komisioni, lidhur me këtë çështje, ka konkluduar se: *Sa i përket këtij pretendimi – megjithëse i mbështetur në deklaratën noteriale të datës 02.02.2021, të nënshkruar mes subjektit dhe shoqërisë “{***}” ShPK – rezulton se në DIPP-në e vitit 2009 subjekti nuk ka deklaruar pagesë të kryer në favor të kësaj shoqërie apo përfaqësuesve të saj ligjorë. Për më tepër, Komisioni evidenton faktin se në vazhdimësi – para nisjes së hetimit administrativ – subjekti ka deklaruar se kjo pagesë është kryer me të ardhurat e tij vjetore të vitit 2010. Gjithashtu, rezulton se vetë kontrata e kaparit nuk referon pagesë të kryer me këste. [...] Për rrjedhojë, në analizën financiare përfundimtare, Komisioni do të reflektojë se kjo vlerë është shlyer tërësisht në vitin 2010, më konkretisht në datën 26.05.2010, me nënshkrimin e kontratës së kaparit.*

15.11. Subjekti i rivlerësimit e kundërshton konkluzionin e mësipërm të Komisionit duke pretenduar specifikisht se:

i) Komisioni nuk ka konsideruar kontekstin dhe të dhënat faktike që e kanë shtyrë subjektin për të kryer pagesën e kaparit, e cila është ndikuar nga elementet si prenotimi i një apartamenti në një objekt që nuk kishte nisur ende të ndërtohej nga shoqëria “{***}” ShPK, duke e parë këtë rrethanë

si një element që i mundësonte pagesën e një çmimi më të ulët, për shkak se me nisjen e ndërtimit në mënyrë të logjikshme çmimi i shitjes mund të rritej;

ii) Komisioni nuk ka pranuar se ndonëse kontrata e kaparit është nënshkruar në datën 26.05.2010, pagesa e shumës së kaparit prej 10.000 eurosh është bërë 500.000 lekë në vitin 2009 dhe pjesa tjetër prej 6.400 euro është paguar në vitin 2010;

iii) meqenëse nga ana e shoqërisë nuk ishin plotësuar kushtet ligjore për lidhjen e një kontrate kapari (pasi nuk ishte marrë leje ndërtimi), për të provuar pagesën e marrë, përfaqësuesi i shoqërisë “{***}” ShPK ka lëshuar 3 mandatpagesa¹¹, në të cilat përshkruhet qëllimi i pagesës dhe shumat e paguara prej subjektit. Pagesa e kryer në vitin 2009 ishte në shumën totale prej 500.000 lekësh. Komisioni në mënyrë të padrejtë nuk ka marrë në analizë këto mandatpagesa dhe as është shprehur lidhur me to;

iv) në kushtet kur nuk kishte formalizuar një marrëdhënie juridike me shoqërinë “{***}” ShPK, nuk ka deklaruar në DVP-në 2009 pagesën prej 500.000 lekësh të realizuar si pagesë e pjesshme e kaparit në këtë vit, pasi në vlerësimin e subjektit, deklarimi i kësaj pagese duhet të lidhej domosdoshmërisht me një veprim juridik (kontratë) mbi të cilën ato ishin paguar;

v) Komisioni nuk ka konsideruar se në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, më datë 19.01.2016, për të justifikuar burimet e ligjshme të pagesës së kaparit, subjekti ka paraqitur si dokumente justifikuese edhe të ardhurat e vitit 2009;

vi) mosdeklarimi i pagesës prej 500.000 lekësh në vitin 2009, mbështetur në jurisprudencën e Kolegjit, se pasaktësitë në deklaratimet periodike të pashoqëruara me pamjaftueshmëri nuk konsiderohen si deklarime të pasaktë në kuptim të ligjit nr. 84/2016, duhet të konsiderohet si gabim njerëzor, i paqëllimtë, që nuk ka të bëjë me asnjë aspekt të fshehjes apo deklarimit të rremë ose të pasaktë të pasurisë.

15.12. Trupi gjykues, në reflektim të qëndrimit të mësipërm, se pagesa e kaparit e realizuar për apartamentit me sip. 78,9 m² ka shërbyer/është transferuar si pagesë e apartamentit me sip. 91,4 m², të ndodhur në të njëjtin objekt, në vijim mori në analizë pretendimin e subjektit se kapari është paguar pjesërisht në shumën 500.000 lekë në vitin 2009 dhe shumën 6.400 euro është paguar në vitin 2010.

Nga analizimi i deklaratimeve të bëra nga subjekti në DVP-në 2009, rezulton se nuk ka asnjë deklaratim lidhur me pagesën e pjesshme të kaparit apo të ndonjë shpenzimi tjetër. Ndërsa në DVP-në 2010, pasi është lidhur kontrata e kaparit me shoqërinë “{***}” ShPK, subjekti deklaroi: *“Lidhur një kontratë kapari, për blerje apartamenti banimi me sip. 79,4 m² në lagjen {***}, Komuna {***}. Paguar për këtë kontratë 10.000 euro dhe ngelur për t’u paguar edhe 22.000 euro. Kjo vlerë është siguruar nga të ardhurat e mija vjetore nga pagat dhe dietat e marra gjatë punës si prokuror”.*

15.13. Ndonëse trupi gjykues, siç analizoi më sipër, nuk vë në dyshim ekzistencën e marrëdhënies së kaparit dhe përdorimin e shumës prej 10.000 eurosh si burim për financimin e apartamentit të

¹¹ Subjekti ka depozituar me procesverbalin nr. 1, tri mandatpagesa: mandatpagesa nr. {***}, datë 02.12.2009, në shumën 200.000 lekë, me përshkrimin “Prenotim apartamenti te {***}”; mandatpagesa nr. {***}, datë 17.12.2009, në shumën 150.000 lekë, me përshkrimin “Këst për prenotimin e apartamentit te {***}”; mandatpagesa nr. {***}, datë 26.12.2009, në shumën 150.000 lekë, me përshkrimin “Këst për prenotimin e apartamentit te {***}”.

ri të porositur prej subjektit, ai sjell në vëmendje se pagimi prej subjektit i shumës prej 500.000 lekësh në vitin 2009, duhej/do të ishte i pritshëm të kishte gjetur pasqyrim në DVP-në e këtij viti, si shpenzim që shkon për krijimin e një pasurie të paluajtshme, apo qoftë edhe si pasqyrim i një marrëdhënie që ndonëse jo e formalizuar zyrtarisht, kishte marrë konsensusin e palëve për lidhjen e saj, e cila, për më tepër, synonte të krijonte të drejta pasurore mbi një pasuri të paluajtshme. Në këto kushte, ndonëse kjo sjellje e subjektit nuk duket se vjen ndesh drejtpërdrejtë me ndonjë dispozitë urdhëruese të ligjit nr. 9049/2003, pasi marrëdhënia e kaparit nuk ishte e formalizuar dhe vlera prej 500.000 lekësh e paguar do të konsiderohej për pasojë, si shpenzim i këtij viti financiar, që duke qenë nën pragun e një shpenzimi të deklarueshëm sipas ligjit të kohës, nuk e kualifikon mungesën e deklarimit si një sjellje në kundërshtim me ligjin, sërish mungesa e këtyre shpjegimeve në DVP-në 2010, kur subjekti e deklaroi kontratën e kaparit dhe pagesën e shumës prej 10.000 eurosh, pa përshkruar një mënyrë të ndryshme pagimi që nuk sugjerohet nga përmbajtja e kontratës, merr një peshë domethënëse në drejtim të mungesës së provueshmërisë së bërjes së kësaj pagese në vitin 2009, pretenduar prej subjektit.

15.14. Deklarimet/shpjegimet e munguara të subjektit edhe në deklaratën *vetting* rreth këtij transaksioni dhe mënyrës së pagimit të detyrimit që vjen prej tij, ndonëse nuk përcaktohen si deklarime të pasakta, në kuptim të burimeve të krijimit të pasurisë, kontribuojnë pavarësisht në pamundësinë e provimit të këtij pretendimi të subjektit, për sa kohë që asnjë e dhënë drejt kësaj mënyre pagese nuk vjen nga deklarimet e tij lidhur me krijimin e kësaj pasurie. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se mungesa/indikimi/shpjegimi nga subjekti në deklaratën *vetting*, lidhur me kontratën e kaparit në deklaratën *vetting*, pavarësisht se është një situatë e cila nuk mund të klasifikohet *a contrario* sipas nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë që të ardhurat e përdorura në shumën 10.000 euro, duket se kanë si burim krijimin të ardhurat nga paga, dhe kapari në vetvete është një instrument për garantimin e ekzekutimit të një detyrimi dhe jo një nga burimet e krijimit të të ardhurave, sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, sërish ky element ka peshë përcaktuese drejt provueshmërisë së këtij fakti.

15.15. Subjekti i rivlerësimit ka synuar të provojë pagesën e pjeshme të kaparit në vitin 2009, nëpërmjet mandatpagesave të depozituara në Komision prej tij. Rezulton se me përgjigjet e dhëna për pyetësonin nr. 1, subjekti, për të provuar pagesën e kaparit pjesërisht në vitin 2009, ka paraqitur edhe 3 (tri) mandatpagesa të lëshuara nga shoqëria “{***}” ShPK, me të dhënat si vijon:

- i) mandatpagesa nr. {***}, datë 02.12.2009, në shumën 200.000 lekë, me përshkrimin “Prenotim apartamenti te {***}”;
- ii) mandatpagesa nr. {***}, datë 17.12.2009, në shumën 150.000 lekë, me përshkrimin “Këst për prenotimin e apartamentit te {***}”;
- mandatpagesa nr. {***}, datë 26.12.2009, në shumën 150.000 lekë, me përshkrimin “Këst për prenotimin e apartamentit te {***}”.

15.16. Përveç sa paraqitur në Komision, subjekti, në ankim, shpjegon se ka paraqitur në ILDKPKI mandatpagesat e pagesave të kryera për apartamentin në Tiranë. Nga aktet e fashikullit të ILDKPKI-së të përcjella së bashku me fashikullin e hetimit administrativ të Komisionit, konstatohet se subjekti, në mbështetje të përgjigjeve të dhëna pranë këtij organi më datë

19.01.2016, ka dorëzuar si dokumentacion mbështetës për kryerjen e pagesave edhe mandatpagesa. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit drejtuar ILDKPKI-së, për përcjellje të dokumentacionin të plotë shkresor lidhur me kontrollat që ky organ ka kryer për subjektin e rivlerësimit për të gjithë periudhën që ai ka qenë deklarues, ky institucion, me shkresën nr. {***} prot., datë 11.10.2023, ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar, tek i cili janë përfshirë edhe procesverbalet e kontrollit të mbajtura me subjektin në datat 19.01.2016, 07.06.2021 dhe 15.06.2021, si dhe dokumentacioni justifikues bashkëlidhur tyre. Nga shqyrtimi i këtyre akteve rezulton se për pagesën e apartamentit nga subjekti janë paraqitur vetëm dy mandatpagesa të lëshuara nga shoqëria “{***}” ShPK, me nr. {***}, datë 21.06.2018 dhe nr. {***}, datë 18.07.2018, ku në të dyja figuron shuma e paguar prej 1.000 eurosh, vula e shoqërisë së ndërtimit, përshkrimi i pagesës *për prenotim apartamenti {***}*, si dhe pala marrëse z. S. D. dhe pala paguese Milan Laskaj.

15.17. Nga shqyrtimi i këtyre akteve, nuk rezultojnë të jenë depozituar në ILDKPKI, mandatpagesat e vitit 2009, të cilat janë dorëzuar në Komision me përgjigjet pyetësorit të parë, të përshkruara më lart, ndonëse subjekti ishte thirrur nga ky institucion dhe përgjigjur pyetjeve për pagimin e çmimit të apartamentit në janar 2016, dhe mund/duhej të kishte depozituar në këtë moment edhe këto akte që provonin burimet e ligjshme për financimin e tij. Përveç mungesës së dorëzimit të mandatpagesave në këtë kohë, nga pyetjet e drejtuara e të pasqyruara në procesverbalin e datës 19.01.2016, lidhur me kaparin, subjekti është përgjigjur se: *“Në lidhje me burimin e krijimit të shumës 10.000 euro, sqarohet se janë nga të ardhurat nga paga dhe dietat për vitin 2010 që sipas vërtetimit të paraqitur janë në vlerën 2.016.646 lekë. Ju paraqes edhe vërtetimin për të ardhurat e vitit 2009 në vlerën 1.485.230 lekë”*, duke mos dhënë sërish ndonjë indikator që mbështet shpjegimet e tij të mëvonshme për pagimin e pjeshëm në vitin 2009. Në këto kushte, kur nuk ka të dhëna që provojnë ekzistencën e mandatpagesave para nisjes së procesit të rivlerësimit kalimtar, trupi gjykues çmon se informacioni që ato ofrojnë, i sjellë vetëm me nisjen e hetimit administrativ, nuk provon tejet çdo dyshimi realizimin e pagesave të pjeshme të kaparit në datat që përcaktojnë mandatpagesat, në dhjetor të vitit 2009.

15.18. Lidhur me pretendimet e subjektit, sipas së cilave *Komisioni nuk i ka dhënë vlerë provuese deklarimeve e shpjegimeve të dhëna nga subjekti në ILDKPKI përpara miratimit të ligjit nr. 84/2016*, trupi gjykues vlerëson se i dha përgjigje në analizën e bërë më sipër, duke potencuar gjithsesi faktin se Komisioni ka bërë një analizë diskrecionale lidhur me fuqinë provuese të këtyre deklarimeve të cilat u gjetën pjesërisht të bazuara prej trupit gjykues sipas konkluzioneve të mësipërme.

15.19. Në përfundim, trupi gjykues, pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit për mënyrën e pagesës së kaparit në shumën 10.000 euro, nuk e gjeti të provuar pretendimin e tij se një pjesë e saj, në vlerën prej 500.000 lekësh, është paguar në vitin 2009. Për rrjedhojë, trupi gjykues konsideroi të paguar për efekt të analizës financiare të gjithë shumën prej 10.000 eurosh, në vitin 2010, sipas përcaktimeve të kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.05.2010 dhe deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore 2010, si dhe në procesverbalin e datës 19.01.2016 të mbajtur në ILDKPKI.

16. Trupi gjykues shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit që lidhen me konkluzionet e Komisionit për ligjshmërinë e burimeve të financimit të apartamentit objekt kontrolli, sipas shkaqeve të përshkruara në pjesën hyrëse të këtij vendimi, e të cilat do të analizohen në vijim, duke konstatuar sa më poshtë.

16.1. Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, ka shpjeguar se ka përdorur një shumë prej 3.000 eurosh, marrë hua prej një kolegu të punës, z. P. H., për të paguar shumën e kaparit në muajin maj 2010, të cilën ia ka kthyer atij në muajin korrik të po këtij viti.

16.2. Në mënyrë të ngjashme, subjekti ka deklaruar edhe marrjen hua të një shume prej 10.000 eurosh nga znj. Z. B., në muajin maj 2010, të cilën e ka shlyer përgjatë këtij viti nëpërmjet një kredie të marrë për këtë qëllim, e të deklaruar si burim për krijimin e pasurisë, por edhe nga të ardhurat e tij nga puna të krijuara deri në fund të vitit.

16.3. Të dyja këto hua, subjekti nuk i ka deklaruar në DVP-në 2010 dhe as në deklaratën *vetting*, si burim të krijimit të pasurisë apartament, me arsyetimin se ato ishin shlyer brenda vitit dhe, për pasojë, nuk ka vlerësuar se do të duhej të deklaroheshin. Ai gjithashtu ka shpjeguar se këto dy hua nuk janë pasqyruar as në deklaratën *vetting*, pasi në momentin e deklarimit ato nuk ekzistonin dhe të ardhurat nga puna, kredia e kursimet e subjektit ishin identifikuar prej tij si burime të krijimit të kësaj pasurie, në pikën fundore të tyre. Për shkak të mosdeklarimit të këtyre huave, Komisioni nuk i ka njohur ato në mesin e burimeve për krijimin e pasurisë apartament, duke konkluduar për secilën prej tyre si në vijim.

16.4. *Për sa i përket huas së deklaruar nga subjekti, si të marrë dhe të shlyer në vitin 2010 nga z. P. H., në vendimin e Komisionit është analizuar dhe konkluduar se: Subjekti, gjithsesi, në rubrikën e deklarimit të pasurive ka pasur detyrimin ta pasqyrojë këtë hua si burim krijimi të shumës së dhënë kapar, pra, të referonte burimin konkret të kryerjes së këtij investimi. Kështu, në formularin e deklarimit të pasurisë, në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë – pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, që i përket deklaratës së interesave privatë të vitit 2010, kërkohet nga deklaruesit që të pasqyrojnë ndryshimet (shtesa dhe pakësime) të ndodhura në interesat pasurorë privatë të deklaruar më parë, për çdo lloj pasurie, të luajtshme dhe të paluajtshme, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit, si dhe burimin e krijimit të pasurisë (në këtë rast të investimit të kryer). Komisioni vëren se në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë të vitit 2010, e cila, sipas parashikimit të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ka vlerën e provës në këtë proces, në përmbushje të këtij detyrimi subjekti ka deklaruar si burim krijimi të këtij investimi vetëm të ardhurat e tij vjetore. Për më tepër, trupi gjykues vlerëson se kjo marrëdhënie huaje, pavarësisht se pretendohet si e mbyllur brenda vitit, do të duhej të deklarohet/raportohej nga subjekti i rivlerësimit, kjo në kuptim të verifikimeve që mund të bëheshin nga ILDKPKI-ja, në përputhje me ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar. Në këtë kontekst, Komisioni arrin në përfundimin se edhe shuma 3.000 euro, e pretenduar si e marrë hua nga shtetasi P. H. në maj të vitit 2010, nuk do të reflektohet si e ardhur që mund të ketë shërbyer në shlyerjen e kaparit për porositjen e pasurisë nga shoqëria “{***}” ShPK.*

16.4.1. Trupi gjykues, në analizë të këtij shkakui ankimi, konstaton, *së pari*, se huaja e deklaruar si e marrë prej z. H. ka shërbyer për financimin e pagesës së kaparit në datën 26.05.2010. Kontrata e kaparit sipas nenit 601 të Kodit Civil¹², nuk është mënyra e fitimit të pronësisë mbi pasurinë apartament, por është një instrument ligjor, i cili ka garantuar të drejtat e palëve për të lidhur në të ardhmen kontratën që kanë siguruar me këtë mjet, në këtë rast porosinë/shitjen e pasurisë. Në këtë kuptim, pasuria apartament nuk është krijuar nëpërmjet kontratës së kaparit, por nëpërmjet kontratës së porosisë nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 19.02.2011, dhe në DVP-në 2011 subjekti duhej të deklaronte burimet e krijimit të saj, ndërsa pagesa e kaparit si një shpenzim është kryer në vitin 2010. Shuma e paguar për llogari të saj nuk përfaqëson tipikisht tiparet e burimit të krijimit të pasurisë, pasi kontrata e porosisë ishte ende e panëshkruar. Për pasojë, trupi gjykues vëren se nuk ka një përcaktim të qartë ligjor për definimin e pagesës së bërë për llogari të një kontrate kapari në deklaratat periodike, për pasojë as një detyrim të qartë ligjor që detyron subjektet të deklarojnë burimet e krijimit të shumës së paguar si kapar në momentin e kryerjes së pagesës, në analogji me burimet e krijimit të pasurisë që deklarohen dhe, si të tilla, ato që përdoren në momentin e kryerjes së pagesës. Sipas kësaj analize, trupi gjykues arrin në konkluzionin se huaja e përdorur për të paguar një pjesë të kaparit, në muajin maj 2010 dhe e shlyer në muajin korrik 2010, sipas deklarimeve të subjektit, nuk ka qenë një veprim i cili detyrimisht duhej të deklarohet në DVP-në e vitit kur janë kryer këto veprime. Për pasojë, mungesa e deklarimit të saj, në DVP-në 2010 në deklaratën *vetting*, nuk e bën atë apriori të pabesueshme.

Për sa i përket konkluzionit të Komisionit se subjekti detyrohet të deklaronte këtë hua në kuptim të detyrimeve që burojnë nga kërkesat e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 9367/2005), e gjen atë pa relevancë në drejtim të analizës mbi detyrueshmërinë e deklarimit sipas ligjit nr. 9049/2003, e cila vlen për të kontrolluar vërtetësinë e deklarimeve të subjektit në funksion të këtij procesi.

16.4.2. Mbështetur në konkluzionin më sipër, trupi gjykues vijoi analizën në funksion të vlerësimit nëse është i besueshëm subjekti në deklaratimet e tij dhe nëse konsiderohet e provuar kjo marrëdhënie, për të vijuar më tej me analizën mbi mundësitë e huadhënësit për të dhënë hua shumën prej 3.000 eurosh.

16.4.3. Për të provuar ekzistencën e kësaj huadhënie, subjekti ka paraqitur në Komision: (i) deklaratë noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.02.2021, të z. P. H., në të cilën ai deklaron për dhënien hua të shumës 3.000 euro subjektit në vitin 2010; (ii) deklaratën periodike vjetore të pasurisë të viti 2009, të dorëzuar në ILDKPKI nga kolegu z. P. H., tek e cila ai deklaron se disponon si kursime në *cash* shumën 1.000.000 lekë dhe 5.960 euro, e cila, sipas subjektit, provon faktin se ai ka disponuar likuiditete për t’ia huazuar atij; si dhe (iii) vërtetime për pagën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare për periudhat: 1 janar 1994 – 31 dhjetor 1997, 1 janar 1998 – 31 dhjetor 2001, 1 janar 2002 – 31 mars 2004, 1 shkurt 2009 deri më 17 prill 2012.

16.4.4. Trupi gjykues vlerësoi deklaratimet e subjektit lidhur me këtë hua, duke konsideruar disa rrethana që dalin nga hetimi administrativ, të cilat shërbejnë për të krijuar një bindje rreth

¹² *Kapar quhet shuma në të holla që njëra nga palët i jep tjetrës për llogari të shumës që do t’i paguhet në bazë të kontratës, me qëllim që të vërtetohet lidhjen e kontratës dhe të sigurojë ekzekutimin e saj.*

ekzistencës së kësaj marrëdhënie, sipas parimit të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. *Së pari*, subjekti i rivlerësimit dhe huadhënësi z. H. ushtronin njëkohësisht detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, duke u provuar në këtë mënyrë marrëdhënia mes kolegësh, siç pretendon subjekti. *Së dyti*, nevoja për marrjen e kësaj huaje, për nevoja të strehimit dhe financimin e pasurisë së parë dhe të vetme të paluajtshme të subjektit, duket si një rrethanë që justifikon krijimin e një marrëdhënie të tillë në kontekstin shoqëror mes dy kolegësh pune. *Së treti*, shuma e marrë hua nuk rezulton të jetë e papërballueshme dhe e paarsyeshme për financat e një prokurori, konsideruar të ardhurat e tij nga puna, pra, krijimi i marrëdhënies duket i natyrshëm, në kontekstin e marrëdhënies së punës dhe të ardhurave respektive. *Së katërti*, siguria e kthimit të shumës në termat kohorë të dakordësuar, pas një periudhe tremujore, për shkak të interesit për të ruajtur të pacenuar marrëdhënien shoqërore që vinte nga marrëdhëniet e punës. *Së pesti*, nga të dhënat e administruara nga Komisioni, trupi gjykues konstaton se, ashtu siç subjekti pretendon në ankim, nga informacioni që përfitohet nga të dhënat e lëvizjeve bankare të llogarisë së subjektit në Raiffeisen Bank, evidentohet tërheqja prej tij e shumës 400.000 lekë më datë 26.07.2010. Ky fakt, i cili i përket vitit 2010, kur pretendohet se ka ndodhur huadhënia, korrespondon me shumën e marrë hua prej 3.000 eurosh, u vlerësua nga trupi gjykues si një element që mbështet pretendimet e subjektit për kthimin e shumës së marrë hua z. P. H., rreth 3 muaj pas kryerjes së pagesës së kaparit, në kushtet kur nuk rezulton asnjë transaksion tjetër financiar i subjektit dhe kur nga llogaria e tij bankare nuk vërehen tërheqje të tjera të kësaj vlere.

16.4.5. Trupi gjykues, në vijim, analizoi mundësinë e huadhënësit z. P. H., për të krijuar me burime të ligjshme shumën prej 3.000 eurosh, të dhëna hua, në kuptim të parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Në këtë këndvështrim, trupi gjykues pati në konsideratë faktin se z. P. H., si subjekt deklarues për shkak të ushtrimit të detyrës së prokurorit, ka deklaruar në DVP-në 2009 se disponon si kursime në *cash* shumën 1.000.000 lekë. Kjo shumë e deklaruar si gjendje në fund të vitit 2010, duket e mjaftueshme për të financuar dhënien e shumës prej 3.000 eurosh në muajin maj të vitit 2010, e të kthyer sërish brenda atij viti, e konsideroi atë si një të dhënë të kohës kur pretendohet se ka ndodhur huadhënia që shkon në mbështetje të pretendimit të subjektit për marrjen e saj. Në vijim, në kuptim të përcaktimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, bazuar në të dhënat e administruara në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kreu një analizë bazike¹³ për huadhënësin për të parë nëse ai mundej të huazonte shumën 3.000 euro në vitin 2010. Nga kjo analizë ka rezultuar se z. P. H. kishte mundësi për të krijuar me të ardhura të ligjshme shumën e dhënë hua prej 3.000 eurosh.

16.4.6. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi të besueshëm deklarimin e subjektit të rivlerësimit për huazimin e një shume prej 3.000 eurosh nga huadhënësi z. P. H., për një periudhë kohore dymujore, maj - korrik 2010, e cila i është kthyer atij nëpërmjet likuiditeteve të tërhequra prej subjektit të rivlerësimit në datën 26.07.2010, siç rezulton nga të dhënat e statementit/vërtetimit

¹³ Nga Njësia e Shërbimit Ligjor, për huadhënësin P. H., është bërë një analizë bazike financiare, në të cilën janë konsideruar vetëm të ardhurat nga pagat për periudhën 1 janar 2009 - 30 prill 2010, dhe janë përfshirë shpenzimet e jetesës për një familje me 4 persona, sipas të dhënave të INSTAT-it të përcjella në Kolegj nga ILDKPKI-ja. Nga kjo analizë rezultoi se huadhënësi kishte mundësi të kursente, në vitin 2009 shumën 2.831 euro dhe për 4 muajt e parë të vitit 2010 shumën 1.040 euro, shumatorja e të cilave kapërcen shumën 3.000 euro dhënë hua subjektit të rivlerësimit në prill të vitit 2010.

bankar të lëshuar nga Raiffeisen Bank të administruar në fashikullin e Komisionit. Trupi gjykues arriti në këtë konkluzion në konsideratë të një sërë rrethanash që justifikonin krijimin e këtij raporti për shkak të marrëdhënieve profesionale dhe personale, vlerës së ulët të shumës, mundësisë së huadhënësit për krijimin e saj me burime të ligjshme, si edhe në konsideratë të faktit se burimi i krijimit të një shume të dhënë kapar nuk barazohet qartazi me burimin e krijimit të një pasurie, në kuptim të dispozitave të ligjit nr. 9049/2003.

17. Në vijim të verifikimit të burimeve për pagimin e vlerës së kaparit prej 10.000 eurosh në vitin 2010, trupi gjykues u ndal në shqyrtimin e pretendimit të subjektit se, *si burim për pagesën e pjesës së mbetur të kaparit kanë shërbyer pagat, si dhe shuma prej 248.000 lekësh e siguruar nga dietat e vitit 2009, të rimbursuara nga institucioni në llogarinë e pagës së subjektit në datën 26.05.2010, të cilat nuk janë njohur nga Komisioni si të tilla në analizën financiare të kryer për pagesën e kësaj shume.*

17.1. Nga të dhënat e analizës financiare të kryer në Komision, rezulton se si pjesë e të ardhurave që kanë shërbyer për pagesën e kaparit në vitin 2010 janë konsideruar vetëm të ardhurat nga punësimi i subjektit në vitin 2010, deri në momentin e pagesës së kaparit, që i përkasin periudhës janar-maj 2010.

17.2. Referuar pretendimit të subjektit se si burim krijimi të shumës së likuiduar janë përdorur dietat në shumën 248.000 lekë të kredituar në llogarinë e pagës më datë 25.05.2010, nga ana e Njesisë së Shërbimit Ligjor të Kolegjit u konstatua se në statementin e llogarisë bankare të subjektit të rivlerësimit lëshuar nga Raiffeisen Bank, më datë 25.05.2010, është kredituar llogaria e pagës së subjektit në vlerën 248.000 lekë, nëpërmjet veprimit me nr. rendor {***}, me përshkrimin “*Dieta Milan Laskaj*”. Një ditë më vonë, në datën 26.05.2010, nga llogaria personale e pagës prej subjektit është tërhequr shuma 250.000 lekë, e cila pretendohet nga subjekti që është përdorur për pagesën e kaparit po në datën e nënshkrimit të kontratës së kaparit, më 26.05.2010. Subjekti ka shpjeguar që kjo vlerë i përket dietave të përfituara prej tij për udhëtimet e punës të kryera në vitin paraardhës 2009, të cilat i janë rimbursuar nga institucioni në maj të vitit 2010. Këto të dhëna sugjerojnë se shpenzimet e udhëtimeve për arsye pune që subjekti ka kryer në vitin 2009, janë mbuluar prej vetë atij me të ardhurat nga paga të vitit 2009. Për këtë arsye, nga ana e Njesisë së Shërbimit Ligjor analiza e vitit 2009 u ngarkua me shpenzimet për udhëtimet e punës së subjektit në këtë vit dhe rezultoi sërish një rezultat financiar me balanca pozitive, fakt që tregon se subjekti ka pasur mundësi që me të ardhurat nga pagat të mbulojë edhe shpenzimet e pretenduara për transport, akomodim dhe dieta ditore.

17.3. Në këto kushte, kur: (i) rezultoi e provuar në akte të kohës (statemente/vërtetime bankare) se shuma prej 248.000 lekësh si pagesë për dieta është kredituar në llogarinë e subjektit në vitin 2010; (ii) subjekti e ka tërhequr këtë shumë nga banka po në ditën që ka lidhur edhe kontratën e kaparit, përkatësisht më datë 26.05.2010; (iii) rezultatin pozitiv financiar për vitin 2009 edhe duke shtuar shpenzimet për kostot e udhëtimeve të punës, trupi gjykues e vlerësoi të besueshëm pretendimin e subjektit se kjo shumë ka shërbyer për të kryer pagesën e kaparit në datën 26.05.2010 dhe e përfshiu atë mes të ardhurave me të cilat është kryer pagesa.

17.4. Për sa më lartarsyetuar, duke konsideruar si burim shumë prej 3.000 eurosh të marrë hua nga z. P. H. dhe të ardhurat nga dietat në vlerën prej 248.000 lekësh, trupi gjykues kontrolloi analizën financiare të kryer nga Komisioni lidhur me pagesën e kaparit në vlerën prej 10.000 eurosh, nga e cila rezultoi se subjekti i rivlerësimit gjendej në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për ta paguar atë, në vlerën prej (-) 309.605 lekësh.

18. Në vijim, trupi gjykues mori në analizë pretendimet e subjektit të rivlerësimit me të cilat kundërshton si të padrejtë dhe të pabazuar në prova analizën dhe konkluzionin e Komisionit lidhur me huan e marrë prej tij nga shtetasja Z. B. në vitin 2011, e të shlyer brenda të njëjtit vit, për të cilin analizon sa vijon.

18.1. Në vendimin e Komisionit, lidhur me huan e marrë nga shtetasja Z. B., *së pari*, është analizuar rreth mungesës së deklaramit të kësaj huaje në deklaratën *vetting*, por edhe në DVP-në 2011, si burim për krijimin e pasurisë, duke e konsideruar këtë mungesë si një rrethanë që e bën të pabesueshëm pretendimin e subjektit të bërë prezent me përgjigjet e pyetësorit, nr. 1 se në janar të vitit 2011 ka marrë hua nga shtetasja Z. B. shumë 10.000 euro, të cilën e ka përdorur për të paguar çmimin e apartamentit, referuar si e likuiduar brenda vitit 2011, të mbështetur edhe nga deklarata noteriale e kësaj shtetaseje, datë 02.02.2021. Në përfundim të analizës së bërë lidhur me këtë hua, Komisioni ka konkluduar se: *Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se si burim për pagesën e kryer në datën 19.02.2011, për porositjen e apartamentit nga shoqëria “{***}” ShPK, kanë shërbyer: (i) të ardhurat e tij vjetore nga paga dhe dietat; (ii) shuma prej 800.000 lekësh nga kredia e marrë në Credins Bank; (iii) shuma prej 200.000 lekësh nga overdraft-i; (iv) shuma prej 5.000 eurosh, hua e marrë nga shtetasi I.M., në datën 12.01.2011; (v) shuma prej 5.000 eurosh, hua e marrë nga shtetasi N. L., në datën 20.01.2011. Nga hetimi i kryer rezultoi se kredia e marrë në Credins Bank dhe overdraft-i i aplikuar po në këtë bankë nuk mund të kenë shërbyer si burim krijimi i kësaj pasurie, pasi kredia në shumë 800.000 lekë është disbursuar në datën 29.07.2011, ndërsa overdraft-i nuk është tërhequr deri në datën 19.02.2011 (data e kryerjes së pagesës). Në këto kushte, Komisioni arrin në konkluzionin se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *vetting* subjekti ka kryer deklaramit të pasaktë të burimeve të krijimit të pasurisë objekt vlerësimi, duke u vendosur në kushtet parashikuara sipas leximit a contrario të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.*

18.2. Trupi gjykues mori fillimisht në analizë pretendimin e subjektit se ai nuk ka bërë deklaramit të pasaktë lidhur me këtë hua, pasi mosdeklarami i saj në DVP-në 2011 e në deklaratën *vetting*, lidhet me faktin se ajo është shlyer brenda vitit 2011 me kredinë e marrë në Credins Bank e të deklaruar si burim për krijimin e pasurisë apartament, e të ardhurat e subjektit nga puna gjatë vitit 2011, po ashtu, të deklaruara si burim i krijimit të kësaj pasurie. Në këtë drejtim, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit nuk janë të bazuara në ligj, pasi, megjithëse subjekti pretendon se kjo hua është shlyer brenda vitit, ai ka pasur detyrimin ta deklaronte atë si burim për pagesën e kryer në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, në deklaratën *vetting*, si dhe në DVP-në e vitit 2011. Detyrimi i subjektit për këtë deklaramit vjen nga parashikimi i nenit 31 të ligjit nr. 84/2016, si dhe shtojcës nr. 2, bashkëlidhur këtij ligji, si edhe sipas urdhërimeve të detajuara të udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, të cilët urdhërojnë deklaramin e burimit të krijimit të pasurisë në momentin e krijimit të saj. Për sa i përket detyrimit për deklaramit,

në zbatim të ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, referuar nga Komisioni si argument ligjor, trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin e mbajtur edhe për huan e marrë nga z. H., sipas së cilit, vlerëson pa relevancë këtë argument lidhur me këtë proces, aq më tepër që në rastin e huas së marrë prej znj. B., vlerësohet i mjaftueshëm për të arritur në një konkluzion për deklarim të pasaktë, parashikimi i dispozitave të cituara më sipër. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë, për sa i përket mosdeklarimit të kësaj huaje, është i drejtë dhe subjekti gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë, sipas leximit, *a contrario*, të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

18.3. Pavarësisht konkluzionit të mësipërm, trupi gjykues mori në analizë pretendimin e subjektit të rivlerësimit me të cilin kundërshton konkluzionin e Komisionit lidhur me mosnjohjen e shumës së marrë hua si burim për pagesën e çmimit të apartamentit në shkurt 2011. Komisioni, lidhur me këtë burim, ka konkluduar se *në kushtet kur rezulton se huaja e pretenduar si e marrë nga shtetasja Z. B. nuk është deklaruar në DIPP-në e vitit 2011 dhe as në deklaratën e rivlerësimit kalimtar vetting, pavarësisht vlerësimit të ligjshmërisë së burimit të të ardhurave të huadhënësit të pretenduar, në analizën financiare kjo shumë nuk do të reflektohet si e ardhur/burim për kryerjen e pagesës nga subjekti në datën 19.02.2011 për prenotimin e pasurisë objekt vlerësimi.*

18.3.1. Trupi gjykues, në funksion të shqyrtimit të këtij shkakui ankimi, analizoi të dhënat që kanë rezultuar nga hetimi administrativ, me qëllim arritjen e një konkluzioni të drejtë lidhur me situatën faktike që subjekti pretendon se ka ndodhur, pavarësisht mosdeklarimit të saj në mënyrën e duhur në deklaratat e pasurisë.

18.3.2. *Së pari*, nga vendimi i Komisionit, konstatohet se shtetasja Z. B. në vitin 2011 ka pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e shumës prej 10.000 eurosh të pretenduar si të dhënë hua subjektit, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

18.3.3. *Së dyti*, ashtu siç pranon dhe Komisioni në vendim, rezulton se kredia në shumën 800.000 lekë e marrë nga subjekti i rivlerësimit nga Credins Bank është disbursuar në datën 29.07.2011, ndërsa overdraft-i nuk është tërhequr deri në datën 19.02.2011, e cila është data e kryerjes së pagesës së apartamentit. Në këto kushte, trupi gjykues, ashtu si edhe Komisioni, çmon se kredia dhe overdrafti nuk janë disponuar nga subjekti si burim të ardhurash në momentin e pagesës së apartamentit më 19.02.2011.

18.3.4. *Së treti*, nga shqyrtimi i të dhënave të akteve të praktikës të akordimit të kredisë në shumën 800.000 lekë, nga Credins Bank, të administruar nga Komisioni, rezulton se ajo është një kredi konsumatore për të cilën subjekti ka lidhur kontratën për kredi afatmesme me nr. {***}, datë 29.07.2011, me objekt kredie “*qëllim respektiv kreditimi konsumatore shlyerje detyrimi*”. Po ashtu, nga të dhënat bankare rezulton se në momentin kur subjekti ka kryer tërheqjen e shumës prej 800.000 lekë, më datë 29.07.2011, në dokumentimin e këtij veprimi bankar e ka përshkruar atë si “*për shlyerje detyrimi*”. Këto të dhëna që rezultojnë nga dokumentacioni bankar, e të krijuara në vitin 2011, vijnë në harmoni me deklaratimet e subjektit se kredia e marrë në Credins Bank ka shërbyer për të kthyer huan e marrë prej Z. B. Përcaktimi i qëllimit të kredisë si një kredi *për shlyerje detyrimi* dhe potencimi i këtij qëllimi edhe në përshkrimin për tërheqjen e shumës nga

banka, duket se mbështet shpjegimet që subjekti ka dhënë në Komision, si dhe në ankim, se shuma e marrë kredi së bashku me të ardhurat nga paga e vitit 2011 kanë plotësuar shumën e kthyer mbrapsht huadhënëses Z. B. në fund të vitit 2011. Në këtë kontekst, konstatohet se kredia e marrë sipas kontratës së mësipërme, e cila ka vijuar të jetë një detyrim për subjektin në fund të vitit 2011, është deklaruar jo vetëm si detyrim i mbartur, por edhe si burim për krijimin e pasurisë. Deklarimi i subjektit lidhur me kredinë si burim krijimi për pasurinë nuk përputhet me qëllimin e marrjes së saj, e cila rezulton se ka qenë për shlyerje detyrimi, që tregon se subjekti e ka perceptuar gabimisht atë si një burim për krijimin e pasurisë, në kuptim të detyrimeve që vijnë nga ligji nr. 9049/2003. Të njëjtin kuptim për detyrimin për deklarim, reflekton subjekti edhe në raport me deklarimin e dy huave të marra për blerjen e apartamentit në vitin 2011, nga shtetasit I. M. e N. L., të cilat i deklarën si të tilla në DVP-në 2011, të shlyera në DVP-të vijuese, e nuk i deklarën si burim në deklaratën *vetting*, pasi ato nuk janë më korrente, duke i zëvendësuar si burim me të ardhurat nga puna, me të cilat ai ka shlyer këto hua. Në këto kushte, pavarësisht këtij defekti në deklarim, trupi gjykues krijon bindjen se shpjegimet e subjektit të mbështetura në të dhënat e mësipërme, por edhe nga deklaratimet e huadhënëses Z. B., në deklaratën noteriale nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 02.02.2021, e cila vjen në harmoni të këto të dhëna, pasqyrojnë të vërtetën jetësore të ndodhur, e cila afekton analizën e burimeve të krijimit të pasurisë. Mosdeklarimi i huas në DVP-në 2011, si edhe në deklaratën *vetting*, besohet se ka ndodhur për një kuptim jo të duhur të subjektit për deklaratimet që ai duhej të kishte kryer dhe nuk provon në këtë rast se kjo hua nuk ka ekzistuar.

18.4. Mbështetur në konkluzionet e mësipërme dhe në konsideratë të faktit se është provuar që huadhënësja Z. B., si person tjetër i lidhur, ka pasur të ardhura të ligjshme për të krijuar shumën e dhënë hua prej 10.000 eurosh, trupi gjykues vlerësoi të përfshijë këtë shumë, si të ardhur në analizën financiare të kryer për verifikimin e burimeve të krijimit të pasurisë.

- 19.** Në vijim, trupi gjykues u ndal në analizimin e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit me të cilat kundërshton *si të pabazuara dhe jo të drejtë analizën dhe konkluzionet e Komisionit lidhur me mundësinë e huadhënësit I. M. për të krijuar me të ardhura të ligjshme shumën e dhënë hua subjektit në vitin 2011*, për të cilat konstaton sa vijon.

19.1. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DVP-në 2011, mes burimeve për krijimin e pasurisë apartament, edhe dy hua të mara nga shtetasit I. M. dhe N. L. në vlerat prej 5.000 eurosh secila. Këto hua rezultojnë të jenë deklaruar si të shlyera në vitet pasardhëse dhe të deklaruara si të tilla në DVP-të respektive. Pavarësisht këtij deklarimi, subjekti nuk i ka deklaruar ato si burime të krijimit të pasurisë në deklaratën *vetting*, me arsyetimin se ato ishin shlyer tashmë dhe ai ka konsideruar se burim fundor i krijimit të pasurisë janë të ardhurat nga puna, të cilat kanë shërbyer edhe për shlyerjen e këtyre huave. Për këtë arsye, Komisioni ka konkluduar se subjekti ka kryer deklarime të pasakta, duke u vendosur në kushtet e një deklarimi të pasaktë, sipas leximit, *a contrario*, të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

19.2. Pavarësisht konkluzionit të mësipërm, Komisioni, duke vlerësuar deklaratimet periodike me cilësinë e provës, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, i ka konsideruar të besueshme deklaratimet e subjektit lidhur me këto marrëdhënie dhe i ka trajtuar huadhënësit me cilësinë e personave të tjerë të lidhur në bazë të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Pas kontrollit të burimeve

të ligjshme të secilit për të mundësuar krijimin e shumave të dhëna hua subjektivit, ka konkluduar se ndërsa huadhënësi N. L. kishte mundësi të krijonte me burime të ligjshme shumë prej 5.000 eurosh, të cilën e ka përfshirë në analizë, huadhënësi I. M. nuk kishte burime të ligjshme për të krijuar të njëjtën shumë dhe nuk e ka përfshirë atë në analizën financiare të kryer për kontrollin e burimeve të krijimit të pasurisë apartament. Sipas Komisionit, *sa i përket shtetasit I. M., gjatë hetimit administrativ subjekti ka depozituar disa dokumente, të cilat tregojnë se ky shtetas ka ushtruar aktivitet tregtar në qytetin e Bajram Currit, në fushën e shitjes së artikujve të ndryshëm, punime druri, por se nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor, ku të evidentohen të ardhura të përfituara prej këtij shtetasi nga ky aktivitet. Edhe pas kalimit të barrës së provës mbi këtë konstatim, Komisioni vëren se subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor të ardhura të përfituara nga shtetasi I. M., të cilat të mundësonin dhënien hua prej tij në janar të vitit 2011 të shumës 5.000 euro.*

19.3. Subjekti i rivlerësimit kundërshton si të pabazuara dhe jo të drejta konkluzionet e mësipërme të Komisionit për analizën financiare të kryer për huadhënësin z. I. M., duke pretenduar se huadhënësi, përveç të ardhurave të siguruara nga aktiviteti i tij tregtar i regjistruar, ka siguruar edhe të ardhura nga aktiviteti i tij si bujk i regjistruar.

19.4. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti, me ankimin, ka paraqitur si provë të re një akt vlerësimi të përpiluar nga ekspertja e fushës së agronomisë ing. Xh. B., i cili mban datën 16.05.2024. Pavarësisht se sipas qëndrimit të arsyetuar më sipër, ky akt nuk u vlerësua të merret me cilësinë e provës së re, pasi nuk plotësonte kriteret e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, trupi gjykues, në funksion të një vlerësimi sa më të plotë të kërkimeve të subjektivit të rivlerësimit, mori në analizë edhe të dhënat që rezultojnë nga ky akt vlerësimi, duke i konsideruar ato si pjesë integrale e ankimit, për sa kohë që në ankim subjekti mbështet pretendimet e tij pikërisht në konkluzionet e këtij akti.

19.5. Nga përmbajtja e akt vlerësimit rezulton se të gjitha përlllogaritjet e ekspertës janë mbështetur mbi faktin që në momentin kur ajo ka kryer këqyrjen e tokave në vitin 2024, ato kanë qenë të mbjella me vreshta e produkte të tjera bujqësore, mbi të cilin ekspertja ka kryer përlllogaritjet, duke supozuar se kjo gjendje e produkteve dhe prodhimtaria e tyre ka qenë e njëjtë për një periudhë 40-vjeçare. Ndërsa ekspertja nuk referon asnjë dokument të kohës apo akt të organeve kompetente vendore që mbulojnë sektorin e bujqësisë, që të provojnë si mbjelljen e tokave bujqësore në vite, ashtu edhe prodhimtarinë e tyre, por ka aplikuar formulat që përdoren për përlllogaritjen e shpronësimit të tokave bujqësore, duke përlllogaritur fitimin *neto* në çdo vit kalendarik të mëparshëm, mbi të dhënat që pasqyrohen në vërtetimin nr. {***} prot., datë 15.04.2024, nga Komuna Margegaj, e cila ka inspektuar tokat në fshatin Çermë, në pronësi të z. I. M.

19.6. Në këto rrethana, konstatohet se konkluzionet e aktit të vlerësimit mbështeten mbi të dhëna hipotetike lidhur me mbjelljen e tokave, kulturat bujqësore e frutore të mbjella në to, sasinë e prodhimit, si dhe kalkulimin e fitimit nga shitja e prodhimit dhe nuk mbështeten në dokumentacion ligjor të kohës kur bëhen përlllogaritjet. Për pasojë, trupi gjykues vlerëson se testi i provueshmërisë së informacionit të këtij akti konsiderohet i pakalueshëm, si për sa i përket prodhimtarisë nga

shfrytëzimi i tokave bujqësore të disponuara nga huadhënësi z. I. M., ashtu si dhe të tregtimit të produkteve bujqësore dhe të të ardhurave të identifikuara si të përfituara nga shitja e tyre.

19.7. Lidhur me pretendimin se huadhënësi z. I. M. që nga viti 1993 ka qenë i regjistruar si person fizik¹⁴ e provuar kjo edhe me vendimin nr. {***}, datë 02.02.1993, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, nëpërmjet të cilit është vendosur njohja e veprimtarisë private të këtij subjekti si shitës i artikujve të ndryshëm dhe punimeve të drurit, si dhe me pajisjen e këtij subjekti me certifikatën e regjistrimit në organin tatimor me numër nr. {***}, në formën tregtare “Tregtar, forma juridike dyqan”, subjekti sjell në vëmendje dhe vërtetimin e lëshuar nga Agjencia e Sigurimeve Shoqërore Tropojë, i datës 13.01.2012, i cili informon/konfirmon se ky shtetas prej 01.04.1993 - 31.12.1996, ka figuruar si i vetëpunësuar si “shitës” në qytetin e Bajram Currit, aktivitetet i ushtruar prej tij në mënyrë të vazhdueshme.

19.8. Gjithashtu, referuar shumës së dhënë hua, subjekti pretendon se shtetasi z. I. M., këto para i ka pasur të depozituara në bankë, për vërtetimin e të cilave subjekti ka paraqitur në Komision *nxjerrje llogarie*¹⁵ nga Raiffeisen Bank, nga e cila provohet se në datën 5 janar 2010 ka pasur në bankë shumën 1.248.216 lekë, ndërsa më datë 23.12.2010 ka tërhequr shumën 500.000 lekë dhe në datën 29.12.2010 ka tërhequr edhe shumën 300.000 lekë, shuma të cilat së bashku, të konvertuara me kursin e këmbimit të kohës, bëjnë rreth 5.000 euro. Sipas subjektit, me aktet e depozituara gjatë hetimit administrativ provohet se huadhënësi ka paguar kontributet për sigurimet shoqërore gjatë kohës së ushtrimit të aktivitetit tregtar si shitës me dyqan, ndërkohë që nuk disponohen të dhëna për *shlyerjen e detyrimeve tatimore*, si dhe provohet se ky shtetas ka ushtruar aktivitetet si bujk për të cilin ka paguar sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

19.9. Trupi gjykues, pavarësisht të dhënave të pasqyruara më sipër, konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë të ardhurat e huadhënësit z. I. M. nga aktiviteti i tij tregtar, në kuptim të standardit të së ardhurës së ligjshme, sipas përcaktimeve të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, me provat e paraqitura në hetimin administrativ, por as ka paraqitur prova të reja me ankimin. Për pasojë, pretendimet e tij, në ankim, mbi të ardhurat e këtij huadhënësi mbeten të paprovuara dhe nuk cenojnë substancialisht konkluzionet e Komisionit lidhur me to.

- 20.** Trupi gjykues, bazuar në konkluzionet e mësipërme, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kontrollon analizën financiare të Komisionit, lidhur me burimet e krijimit të pasurisë apartament objekt kontrolli, nga e cila rezultoi se subjekti i rivlerësimit gjendej në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, për pagesën e këstit të parë, në datën 09.02.2011, në një vlerë prej 1.131.131 lekësh, situatë që e vendos subjektin në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

¹⁴ Që nga viti 1993 ka ushtruar aktivitet privat që lidhet me shitjen e artikujve të ndryshëm dhe me punime artistike druri, kryesisht vegla muzikore, çifteli, lahute etj., të cilat janë shitur prej tij në mënyrë të vazhdueshme dhe për të cilat është nderuar dhe me çmime në aktivitete të ndryshme artistike. Këto artikuj janë shitur në Shqipëri dhe në Kosovë.

¹⁵ Në pyetësin nr. 2, subjekti ka paraqitur statement të llogarisë bankare të shtetasit I. M. për periudhën 05.01.2010-31.12.2011 ku përfshihet periudha në të cilën subjekti ka marrë hua, dhe vërtetohet se në bankë ky shtetas ka pasur kredite të vazhdueshme si dhe shuma të konsiderueshme në llogari që sipas tij kanë ardhur nga aktiviteti tregtar.

21. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit me të cilat kundërshton si të pabazuar në ligj dhe në prova, si dhe konsideron jo të drejtë konkluzionin e Komisionit, referuar gjendjes së kursimeve cash të disponuara prej tij dhe bashkëshortes në datën e dorëzimit të deklaratës vetting më 26.01.2017, trupi gjykues analizon dhe konkludon sa vijon.

21.1. Nga vendimi i Komisionit, lidhur me kursimet në cash të bashkëshortes së subjektit, rezulton se shuma prej 1.000.000 lekësh e deklaruar si e ardhur nga disa vite pune dhe jo kursime, nga personi i lidhur në DVP-në 2014, që është edhe deklarimi i parë i saj, nuk është pranuar si burim i krijimit të shumës prej 1.000.000 lekësh gjendje cash, deklaruar prej subjektit në deklaratën vetting. Mbështetur mbi këtë qëndrim, Komisioni ka konkluduar se të ardhurat e përfituara nga subjekti dhe personi i lidhur në janar të vitit 2017 nuk janë të mjaftueshme për të mundësuar krijimin e kursimeve në formë likuiditetesh cash në shumën 1.000.000 lekë deri në datën 26.01.2017 (data e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar vetting), duke bërë që subjekti të gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

21.2. Subjekti i rivlerësimit, duke kundërshtuar këtë konkluzion të Komisionit, ka pretenduar se: (i) Komisioni nuk ka pasqyruar saktë situatën dhe rrethanat dhe as i ka vlerësuar drejtë ato, pasi nga një konstatim për deklarim të pasaktë në deklaratën vjetore periodike të gjendjes së cash-it, është arritur në konkluzionin përfundimtar që subjekti gjendet në mungesë burimesh për krijimin e kësaj pasurie nga personi i lidhur; (ii) Komisioni nuk ka pasqyruar në mënyrë të plotë rrethanat faktike e ligjore në të cilat është gjendur personi i lidhur dhe në vendimin objekt ankimi nuk konstatohet të jenë vlerësuar apo analizuar provat e depozituara nga bashkëshortja, në cilësinë e personit të lidhur, por dhe në cilësinë e kandidatës për gjyqtare, e cila, si e tillë, ka kaluar filtrat e kontrollit të pasurisë.

21.3. Në funksion të shqyrtimit të këtij shkakui ankimi, trupi gjykues mori në analizë deklaratimet e personit të lidhur, si dhe të dhënat e administruara në fashikullin e Komisionit, lidhur me të ardhurat e saj vjetore, nga të cilat u konstatua se:

Së pari, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar për herë të parë pasurinë dhe interesat privatë në vitin 2014, duke plotësuar pjesën e deklaratës periodike të pasurisë të subjektit, për vitin 2014, që i atribuohet personit të lidhur, pa specifikuar cilësinë si bashkëshorte apo bashkëjetuese¹⁶. Kjo shtojcë e plotësuar prej personit të lidhur, duke qenë pjesë e deklaratës periodike të pasurisë së subjektit, dikton deklarimin e *shtesave dhe pakësimeve të pasurisë të ndodhura në vitin për të cilin deklarohet*, pra, në vitin 2014. Konkretisht, në këtë shtojcë të deklaratës, kërkohet që personi i lidhur apo fëmija madhor të deklarojë: *“Ndryshimet e pasurive dhe burimin e krijimit”*¹⁷. Ky formatim i DVP-së nuk vjen tipikisht dedikuar një deklarimi fillestar por, si pjesë e një deklarimi periodik, situatë që e bën të nevojshëm analizimin e të dhënave të deklaruara rishtas në të, në një kontekst, disi të veçantë për të cilin nuk ka një rregullim të posaçëm.

¹⁶ Martesa ligjore e subjekti të rivlerësimit Milan Laskaj dhe znj. S. L. është bërë më 17.07.2015.

¹⁷ Në DVP-në 2014 të administruar në fashikullin e ILDKPKI-së të plotësuar nga personi i lidhur në formën e plotësuar prej saj (në faqen 9-të) kërkohet të deklarohen *“ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”*.

Së dyti, në deklaratën fillestare të vitit 2014, bashkëshortja e subjektit në rubrikën *“Të ardhura nga angazhime në veprimtari publike dhe ose/private”* ka deklaruar: vlerën prej 1.000.000 lekësh si të të ardhura nga puna si avokate dhe të tjera ndër vite. Në kushtet kur të gjitha rubrikat e shtojcës së deklarimit të personit të lidhur në DVP-në 2014, sugjerojnë deklaratimet e ndryshimeve të pasurisë të ndodhura në vitin për të cilin deklarohet, asnjë prej tyre nuk përkufizon krejtësisht deklarimin e kësaj shume si kursim, ashtu siç Komisioni përcakton në vendim, por do të duhej që personi i lidhur me shpjegime të informonte/shpjegonte rreth asaj që përfaqëson kjo shumë dhe burimet e krijimit të saj. Nisur nga këto konstatime, rezultojnë se qëndrimi i Komisionit se: *Si rrjedhim, trupi gjyqës vlerëson se personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, në cilësinë e subjektit që mbart detyrimin për deklarim, ka pasur detyrimin të deklaronte saktë dhe në rubrikën përkatëse gjendjen e pasurisë në formë likuiditetesh cash*, nuk është i saktë dhe shterues, pasi në këtë rast Komisioni duhet të analizonte, së paku, nëse: (i) ky deklarim i mundësonte ose jo këtij organi kontrollin për identifikimin e pasurisë së personit të lidhur, ashtu edhe për burime të krijimit të saj; dhe (ii) nëse deklarimi i personit të lidhur në DVP-në 2014 e lidh tërësisht ose jo krijimin e shumës 1.000.000 lekë, vetëm me të ardhurat nga veprimtaria private gjatë vitit 2014 apo është një shumë që i korrespondon të ardhurës së krijuar nga puna 3-vjeçare e personit të lidhur si avokate. *Së treti*, përderisa në përmbajtjen e deklarimit të bërë nga bashkëshortja/bashkëjetuesja e subjektit për shumën 1.000.000 lekë, qoftë ose jo në rubrikën e duhur të DVP-në 2014, duke vendosur përshkrimin *“Të ardhura nga puna si avokate dhe të tjera ndër vite”*, duket se personi i lidhur ka orientuar nevojën e kryerjes së analizës financiare për të verifikuar në radhë të parë nëse ajo ka pasur mundësi për të krijuar këtë shumë me të ardhurat ndër vite nga aktiviteti si avokate, i nisur në vitin 2012. Për pasojë, përshkrimi i shumës prej 1.000.000 lekësh, si të ardhura në vite, përjashton analizimin e saj si të krijuar vetëm në vitin 2014, siç Komisioni ka arsyetuar.

21.4. Nga të dhënat e fashikullit të Komisionit, rezultojnë se ky organ nuk ka bërë një analizë financiare për të kontrolluar mundësinë e personit të lidhur për të krijuar shumën 1.000.000 lekë nga aktiviteti si avokate ndër vite dhe nga burime të tjera të përmendura në këtë deklaratë, por e ka analizuar atë në dy drejtime:

i) Në drejtimin e parë, e ka analizuar si pasuri të ekonomisë familjare të krijuar në vitin 2014, duke konkluduar se subjekti dhe bashkëshortja së bashku në këtë vit nuk kishin mundësi për krijimin e saj. Ky trajtim, i cili, ndonëse nuk ka gjetur pasqyrim në vendim, rezultojnë si i tillë nga shifrat e përfshira si pjesë e analizës financiare të bërë nga Komisioni, është i gabuar, pasi këtë shumë e konsideron si pasuri të krijuar në vitin 2014 nga ekonomia familjare, duke ardhur në kundërshtim me përshkrimin që personi i lidhur i ka bërë kësaj pasurie në DVP-në 2014, si të krijuar prej saj me të ardhurat në vite.

ii) Në drejtimin e dytë, rezultojnë se Komisioni, duke abstraguuar nga analiza e bërë më lart, që e konsideron shumën si të krijuar nga ekonomia familjare gjatë vitit 2014, e ka analizuar atë si të krijuar sërish nga ekonomia familjare, por me të ardhura të krijuara nga 1 janar - 26 janar 2017, dhe ka konkluduar se *të ardhurat e përfituara nga subjekti dhe personi i lidhur në janar të vitit 2017 nuk janë të mjaftueshme për të mundësuar krijimin e kursimeve në formë likuiditetesh cash në shumën 1.000.000 lekë deri në datën 26.01.2017 (data e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar vetting), duke bërë që subjekti të gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.*

21.5. Në këto kushte, duket se deklarimi i bërë në deklaratën *vetting* vjen në harmoni me deklarimin e bërë prej saj në deklaratën e pasurisë të vitit 2014, dhe sërish evidenton se krijimi i shumës 1.000.000 lekë si kursim në *cash* është deklaruar si i krijuar nga personi i lidhur. Për pasojë, trupi gjykues çmon se kryerja e një analize të ndryshme nga sa deklarohet në këtë deklaratë, duket jo e saktë.

21.6. Nga sa analizuar më sipër, trupi gjykues konstaton se në analizën financiare të bërë nga Komisioni ka munguar krejtësisht konsiderimi i krijimit të shumës prej 1.000.000 lekësh nga personi i lidhur, prej të ardhurave nga punësimi i saj si avokate dhe nga dhurimet e të afërmeve, ndërsa rezulton se personi i lidhur në deklaratën *vetting* ka deklaruar se dispononin kursime në *cash* në shumën 1.000.000 lekë, të krijuara nga *veprimtaria e saj si avokate dhe nga dhurata të njerëzve të afërt*, deklarim që vjen në harmoni me përshkrimin e bërë prej saj në DVP-në 2014.

21.7. Në këto kushte, trupi gjykues, duke iu referuar konstatimeve të mësipërme, e gjen të padrejtë analizën e kryer në Komision për kontrollin e mundësisë së subjektit dhe personit të lidhur për të krijuar këtë shumë në periudhën 1 janar - 26 janar 2017. Për rrjedhojë, trupi gjykues, me ndihmën e Njësisë së Shërbimit Ligjor, në Kolegj, kontrollon ligjshmërinë e të ardhurave të siguruar prej bashkëshortes me burim nga: **a) aktiviteti i avokatisë** gjatë viteve 2012 – 2014; si dhe **b) dhurimi i shumës prej 500.000 lekësh** nga të afërmit para martesës.

21.8. Lidhur me të ardhurat e personit të lidhur S. L., nga puna si avokate, është konstatuar se bashkëshortja e subjektit ka qenë e punësuar në periudhat dhe në entitetet, si dhe ka përfituar të ardhura si vijon:

- i) për periudhën maj 2012 – shtator 2013, punësuar në subjektin tregtar “{***}”¹⁸, person fizik (avokat), me të ardhura nga paga në shumën totale të konfirmuara nga *statement-i* bankar prej 306.000 lekësh;
- ii) për periudhën janar – shtator 2014, në subjektin tregtar “{***}”¹⁹, si person fizik dhe për periudhën tetor – dhjetor 2014, figuron me raporte barrëlindje²⁰ po në subjektin tregtar “{***}”, me të ardhura nga paga në shumën totale të konfirmuara nga *statement-i* bankar prej 209.000 lekësh;
- iii) për periudhën tetor – dhjetor 2014, figuron me raporte barrëlindje dhe të ardhura në shumën 48.704 lekë;

¹⁸ Sipas shkresës me nr. {***}, datë 24.02.2017, lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, të ardhurat nga paga neto e përfituar nga S. L. për periudhën Maj 2012-Shtator 2013 rezultojnë të jenë në shumën 298.818 lekë, ndërsa nga ana e Komisionit këto të ardhura janë identifikuar në shumën 306.000 lekë.

¹⁹ Sipas shkresës me nr. {***} prot., datë 15.09.2016, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë, të ardhura nga paga e përfituar nga personi fizik për periudhën janar 2014 – dhjetor 2014 rezultojnë të jenë në shumën 160.296 lekë (ndërkohë nga Komisioni janë identifikuar në shumën 209.000 lekë. Në shifrën e identifikuar nga Komisioni është përfshirë dhe raporti i barrë lindjes së përfituar nga bashkëshortja për periudhën shtator – dhjetor 2014 në subjektin tregtar “{***}” person fizik (avokat).

²⁰ Sipas *statement-it* bank (Raiffeisen Bank) të ardhura nga raporti i barrë lindjes në shumën 40.195 lekë, ndërsa sipas Komisionit në shumën 48.704 lekë.

iv) për vitin 2014, të ardhura nga fitimi *neto* prej ushtrimit të aktivitetit të avokatisë²¹ në shumën 189.000 lekë.

Shuma totale e të ardhurave të ligjshme nga aktiviteti i avokatisë gjatë periudhës maj 2012 – dhjetor 2014 e identifikuar, sipas Komisionit²², ka rezultuar në vlerën 703.000 lekë.

21.9. Nga Njësia e Shërbimit Ligjor në Kolegj, mbështetur në të dhënat e korrespondencës së disponuar në fashikullin e Komisionit, është kryer një analizë bazike mbi mundësinë financiare të bashkëshortes së subjektit për të krijuar gjendjen e likuiditeteve të pretenduara për periudhën 2012-2014. Në këtë analizë është marrë në konsideratë deklarimi i bashkëshortes si person i lidhur me subjektin në DVP-në e vitit 2014, në të cilën të ardhurat nga *puna si avokate dhe të tjera ndër vite janë deklaruar në shumën 1.000.000 lekë*. Nga të dhënat e korrespondencave me institucionet përkatëse (Administratën Tatimore dhe Institutin e Sigurimeve Shoqërore), janë identifikuar të ardhura në shumën totale të siguruara nga *puna si avokate* prej 696.572 lekësh. Meqenëse në deklarin e parë të bërë në vitin 2014, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar shumën e të ardhurave ndër vite, për të cilat pretendon se përfaqësojnë gjendjen e likuiditeteve *cash* të disponuara prej saj në fund të vitit 2014, në funksion të identifikimit të mundësisë financiare për të kursyer shumën e pretenduar prej subjektit, në analizën bazike të kryer në Kolegj, shpenzimet e jetesës për vitin 2014 i janë ngarkuar ekonomisë familjare, meqë bashkëshortët kishin nisur bashkëjetesën, ndërsa për dy vitet e mëparshme 2012 – 2013, i janë ngarkuar të ardhurave të personit të lidhur. Nga analiza financiare e kryer sipas kësaj metodologjie ka rezultuar se bashkëshortja e subjektit kishte mundësi të kursente shumën prej 421.952 lekësh, shumë e cila justifikon pjesërisht krijimin e gjendjes së *cash-it* të pretenduar/deklaruar prej saj dhe subjektit të rivlerësimit.

21.10. Në vijim, trupi gjykues u ndal në verifikimin e mundësisë për të krijuar me burime të ligjshme shumat e pretenduara si të dhuruara nga familjarët dhe të afërmit për lidhjen e martesës.

21.10.1. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në fashikullin e Komisionit, u konstatua se subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë ligjore me personin e lidhur në datën 17.07.2015²³, ndërsa ceremonia e martesës ka ndodhur në datën 27.07.2013. Në DVP-të 2014 dhe 2015, personi i lidhur nuk ka deklaruar likuiditete me burim vlera monetare të dhuruara në favorin e saj, si dhe nuk ka deklaruar as të ardhura nga ky burim, por ka lënë gjurmë për këtë burim, që në DVP-në 2014 -- *të ardhura nga puna si avokate dhe të tjera ndër vite* -- si dhe e ka deklaruar atë në

²¹ Sipas shkresës me nr. {***}, datë 27.07.2017, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë, fitimi i vitit 2014 për subjektin tregtar “{***}” person fizik (avokat) rezulton të jetë në shumën 188.754 lekë, ndërsa nga Komisioni rezulton të jetë identifikuar në shumën 189.000 lekë.

²² Sipas Komisionit, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje Komisioni konstaton se të dhëna të punësimit të shtetases S. L., fillojnë në maj 2012. Nga maji i vitit 2012 deri në datën 31.12.2014, të ardhurat totale të personit të lidhur të konfirmuara me dokumentacion justifikues ligjor janë në shumën prej rreth 703.000 lekë, e konkretisht të ndara si vijon: (i) nga paga si e punësuar në subjektin tregtar “{***}” person fizik (avokat), për periudhën maj 2012 – shtator 2013, në vlerën prej 306.000 lekë; (ii) të ardhura nga paga dhe pagesë raporte barrëlidje, si e vetëpunësuar në subjektin tregtar të regjistruar në emër të saj “{***}” person fizik (avokat), për periudhën janar – dhjetor 2014, në vlerën prej 209.000 lekësh; (iii) të ardhura nga fitimi *neto* prej ushtrimit të aktivitetit të avokatisë për vitin 2014, në shumën prej 189.000 lekësh.

²³ Sipas dokumentit “Certifikate Martese” nr. serial {***}, lëshuar në datën 25.01.2017, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së.

deklaratën vetting - cash, kursime nga veprimtaria private si avokate dhe dhuratat e njerëzve të afërm.

21.10.2. Në përgjigje të pyetjeve të Komisionit në pyetësorin nr. 4, subjekti ka deklaruar mbi identitetin e personave të cilët i kanë dhuruar vlera monetare bashkëshortes së tij, duke evidentuar shumën, mënyrën, kohën e dhurimit, si dhe ka depozituar për çdo rast dokumentacion justifikues mbi ligjshmërinë e të ardhurave të 4 (katër) personave të cilët, në kuptim të përcaktimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, janë konsideruar nga Komisioni si persona të tjerë të lidhur të subjektit. Nga verifikimi i analizës financiare të bërë nga Komisioni, në kuptim të përcaktimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e depozituar në Komision nga subjekti, konfirmoi si të drejtë analizën e bërë për huadhënësit Sh. Sh., M. K. dhe D. M. Ndërsa për huadhënësin Q. M.²⁴, në Kolegj, mbi bazën e një analize bazike të ardhurave dhe

²⁴ Q. M., djali i dajës së nënës, N. L. (C.), i ka dhuruar shumën prej 200.000 lekësh në muajin Gusht të vitit 2013. Për të justifikuar këtë dhurim, sipas Komisionit, subjekti ka depozituar një dokument të përkthyer nga gjuha italiane “shkresë e thjeshtë”, ku për periudhën korrik dhe gusht të vitit 2013, ky shtetas dhe bashkëshortja e tij kanë përfituar në total të ardhura në shumën prej 4.444 eurosh. Rezulton se për muajin korrik të vitit 2013, të ardhurat e Q. M. dhe bashkëshortes së tij, F. M., janë në total në shumën prej 1.783 eurosh. Të ardhurat e përfituara për muajin korrik 2013 prej 1.783 eurosh, duket se nuk janë të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të jetesës dhe aq më pak për dhurimin e shumës prej 200.000 lekësh personit të lidhur. Në të tilla kushte këto të ardhura nuk janë konsideruar nga Komisioni si burim krijimi i shumës së dhënë hua.

Nga verifikimi i dokumentacionin të disponuar në fashikull, rezulton se në fashikullin e hetimit administrativ, disponohet një statement i llogarisë bankare me numër {***/{***/} për periudhën 22.05.2013-30.06.2013 ku evidentohen kreditime dhe pagesa të kryera, që pas të cilave gjendja në datën e fundit të muajit qershor në këtë llogari rezulton në shumën 12.937.11 Euro. Nga statement-i bankar identifikohet numri i llogarisë i cili është i njëjtë me numrin e llogarisë të përdorur nga Shoqëria {***/} S.C.R.L për pagesat/kreditimet ndaj të punësuarës F. M. që prej janarit të vitit 2013.

Në vijim të dokumentacionit të sjellë nga subjekti nëpërmjet pyetësorit nr. 2, rezulton se janë sjellë vërtetime të lëshuara nga:

- Shoqëria “{***/}” mbi të punësuarin Q. M., i punësuar që nga data 05.07.2006 nga ku identifikohen të ardhurat: për muajin qershor 2013 (me datë pagese 10.07.2013) në shumën neto 1.304 euro; për muajin korrik 2013 (me datë pagese 07.08.2013) në shumën neto 2.702 euro; për muajin gusht 2013 (me datë pagese 10.09.2013) në shumën neto 1.301 euro.

- Shoqëria {***/} S.C.R.L, për të punësuarën F. M., e punësuar që nga data 01.01.2013 nga ku identifikohen të ardhurat: për periudhën 12.07.2013 në shumën neto 480.28 euro; për periudhën 13.08.2013 në shumën neto 569.55 euro; për periudhën 12.09.2013 në shumën neto 582.98 euro.

Nga dokumentacioni i disponuar në fashikull vihet re që F. M. ka një llogari në të cilën përveç kreditime me kupona apo pagesa me çek të jashtëm, janë kryer dhe kreditime nga shoqëria në të cilën ajo punon që nga janari i vitit 2013, në llogarinë me likuiditet gjendje prej 12.937.11 eurosh në datën 30.06.2013. Gjithashtu nga vërtetimet e lëshuara nga Shoqëria {***/}, Q. M. rezulton i punësuar në këtë shoqëri që prej vitit 2006, dhe sipas vërtetimit të tre muajve të fundit, të ardhurat mujore lëvizin nga 1.300 euro – 2.700 euro.

Në funksion të evidentimit të mundësisë së kësaj familje për të kursyer shumën prej 200.000 lekësh, e pretenduar kjo si e dhuruar në dasmën e mbesës (sipas deklaratës noteriale daja nuk ka pasur mundësi të vinte në datë 27.07.2013 kur është zhvilluar ceremonia e martesës, por ka ardhur pas dasmës në Shqipëri) në vijim nga ana e Njesisë së Shërbimit Ligjor është bërë një analizë bazike e tre muajve të fundit (qershor – gusht 2013), për të cilat disponohen të dhëna si vijon.

Nga kjo analize bazike vihet re që, të ardhurat e muajit korrik janë në shumën totale 3.272 euro, nga të cilat duke zbritur shpenzimet e jetesës në nivel mesatar për një familje, të dhënat këto të marra nga Istat Italy, shuma e kursyer është në vlerën 1.283 euro, e cila e konvertuar me kursin e këmbimit valutor të vitit 2013 është ekuivalent me shumën 179.826 lekë, vlerë e cila është e përafërt me shumën 200.000 të pretenduar nga bashkëshortja/subjekti si e dhuruar nga daja. Kjo vlerë e konkluduar nga analiza financiare e mësipërme, e parë në mënyrë integrale dhe me statement-in e llogarisë bankare të znj. F. M., në të cilën rezulton një gjendje likuiditeti prej 12.937 eurosh, krijojnë bindjen se kjo familje ka pasur mundësi të krijonte me burime të ligjshme shumën prej 200.000 lekësh për t’ia dhuruar mbesës me rastin e martesës. Të dy bashkëshortet e familjes janë në marrëdhënie pune dhe kanë pagesa të përmuajshme në llogarinë bankare, shuma të cilat tregojnë për gjendjen ekonomike e cila justifikon dhurimin. Nga sa përshkruar me

shpenzimeve, sipas asaj që rezulton nga aktet e administruara në Komision, u konstatua se ai dhe bashkëshortja e tij F. M. kishin mundësi me të ardhura të ligjshme për t'i dhuruar bashkëshortes se subjektit shumën 200.000 lekë.

21.10.3. Pas verifikimit të dokumentacionit të përcjellë në Komision nga subjekti për të ardhurat e personave të tjerë të lidhur, që identifikon se i kanë dhuruar bashkëshortes së tij shuma monetare me rastin e martesës, personi i lidhur mund të justifikojë burimet e ligjshme të dhuruesve për: (i) shumën 100.000 lekë, dhuruar nga Sh. Sh. (C.), për të cilën dhe Komisioni kishte arritur në të njëjtin konkluzionin; si dhe (ii) shumën 200.000 lekë të dhuruar nga Q. dhe F. M.

21.11. Në konsideratë të konkluzionit të mësipërm, se nga puna si avokate, personi i lidhur arrin të justifikojë krijimin e shumës prej 421.952 lekësh, shtuar vlerën e provuar si të krijuar me burime të ligjshme nga dhuruesit në vlerën 300.000 lekë, në total shuma e justifikuar me burime të ligjshme është në shumën 722.000 lekë, e cila e ekspozon subjektin në një diferencë negative prej 278.000 lekësh për justifikimin e gjendjes së *cash-it* prej 1.000.000 lekësh, të deklaruar në deklaratën *vetting*.

21.12. Gjithashtu, rezulton se personi i lidhur, për shkak të statusit si kandidate për magjistrate, ka kaluar filtrat e kontrollit të pasurisë nga ILDKPKI-ja, e cila, me shkresën nr. {***} prot., datë 07.07.2020, i ka përcjellë Këshillit të Lartë Gjyqësor, raportin e kontrollit përkatës në të cilin është konkluduar se deklarimi i personit deklarues S. L., është i saktë dhe në përputhje me ligjin dhe se ka burime të ligjshme për të justifikuar pasurinë, akt, i cili, edhe pse është përcjellë në Komision, nuk është konsideruar në vlerësimin e pasurisë likuiditete *cash*, duke mos mbajtur asnjë qëndrim lidhur me të.

21.13. Në përmbledhje të sa më sipër, lidhur me gjendjen e likuiditeteve *cash* në vlerën 1.000.000 lekë, të deklaruar si të tilla në deklaratën *vetting*, nga personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit, trupi gjykues, në ndryshim nga Komisioni, kreu një analizë financiare rreth mundësisë së krijimit të saj për të gjithë periudhën e përshkruar prej personit të lidhur në deklaratat e pasurisë. Nga kjo analizë rezultoi se personi i lidhur kishte mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj gjendjeje në vlerën prej 278.000 lekësh. Trupi gjykues e gjeti këtë balancë negative jo përcaktuese për kriterin e vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, përderisa ajo ishte një pasuri e bashkëshortes e krijuar para fillimit të bashkëjetesës dhe, për më tepër, i ishte nënshtruar një kontrolli nga një organ tjetër kushtetues, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në kuadër të verifikimit të pasurisë së personit të lidhur me cilësinë e kandidates për magjistrate, dhe ishte gjetur pa asnjë pasojë në drejtim të karrierës së saj profesionale. Për pasojë, ngarkimi i subjektit me përgjegjësi për këtë balancë negative u vlerësua prej trupit gjykues, si joproporcional.

22. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, që kundërshton qëndrimin e Komisionit *se automjeti me targa {***}, është pasuri e fshehur e tij, është një konkluzion jo i drejtë, i marrë për*

sipër, ndryshe nga Komisioni, vlerësoj se shuma prej 200.000 lekësh duhet të bëhet pjesë e analizës financiare të bashkëshortes së subjektit për të justifikuar shumën e pretenduar prej 500.000 lekësh si dhurim nga të afërmit me rastin e ceremonisë së martesës.

shkak të analizimit të gabuar të situatës faktike dhe të provave, që vjen në kundërshtim me jurisprudencën e Kolegjit, trupi gjykues analizon sa vijon.

22.1. Në vendimin e Komisionit, lidhur me automjetin me targa {***}, është analizuar se, ndërsa rezulton se në momentin e dorëzimit të deklaratës *vetting*, subjekti i rivlerësimit rezulton ta ketë pasur në përdorim automjetin në fjalë, sipas ekzistencës së policave të sigurimit të vlefshme, ku ai figuron si “përdorues”, si edhe nga evidencat e udhëtimeve jashtë vendit të kryera prej tij, si përpara ashtu edhe pas dorëzimit të deklaratës, ai nuk e ka deklaruar përdorimin e kësaj pasurie në këtë deklaratë, në kundërshtim me detyrimin e parashikuar në nenin D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, duke qenë se subjekti, jo vetëm nuk e ka deklaruar këtë pasuri të luajtshme në përdorim në deklaratën *vetting*, por duke marrë parasysh se ai duket se ka ushtruar kontroll të plotë mbi automjetin dhe e ka përdorur vazhdimisht, madje edhe pas ndryshimit të pronësisë, Komisioni ka krijuar dyshime të arsyeshme se mund të kemi të bëjmë me një pasuri të fshehur të subjektit. Komisioni ka konsideruar pa peshë pretendimin e subjektit se shtetasit A. L. dhe B. D. kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie, me qëllim rrëzimin e dyshimeve për pasuri të fshehur, duke arsyetuar se pasja e burimeve të ligjshme për blerjen e pasurisë prej pronarëve *de jure* të automjetit nuk mund të konsiderohet si rrethanë e vetme vendimtare për përjashtimin e këtij konkluzioni, por duhet të analizohet në mënyrë tërësore, në raport me të gjitha indiciet e tjera të evidentuara. Si konkluzion, mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimit administrativ, si dhe provat shpresore të administruara në dosje, Komisioni arriti në përfundimin se kemi të bëjmë me pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit dhe se ai gjendet [...] në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, çka përbën shkak për shkarkimin e tij, në kuptim të pikës 3 të nenit 61 të këtij ligji.

22.2. Në ankim, subjekti i rivlerësimit kundërshton analizën dhe konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri, duke pretenduar në mënyrë të përmblodhur se: (i) është e papranueshme se meqenëse subjekti provohet se ka përdorur automjetin në datat 18.07.2015; 08.12.2015 dhe 30.07.2017, atëherë automjeti të prezumohet automatikisht se ka qenë në përdorim të tij të vazhdueshëm; (ii) Komisioni ka lënë pa shpjegim faktin, përse subjekti do të fshihte përdorimin e këtij automjeti, për të cilin ka kryer veprime juridike para noterit në kushtet kur kishte burime të ligjshme për blerjen e tij dhe, po ashtu, edhe personat që janë pronarë të këtij automjeti provohet se kishin, po ashtu, të ardhura të ligjshme për blerjen; (iii) është lënë jashtë vlerësimit fakti se shtetasi B. D., më datë 22.06.2020, në ushtrimin e tagrave të pronarit, ka shitur automjetin me targa {***}; (iv) konkluzioni se automjeti me targa {***} është pasuri e fshehur e subjektit, është marrë në kundërshtim me jurisprudencën e Kolegjit, e cila në të gjitha rastet kur ka konkluduar për fshehje pasure, si argument kryesor mbi të cilin ka mbështetur këtë vendimmarrje, ka qenë mungesa e burimeve të ligjshme të subjektit për të justifikuar blerjen e pasurisë.

22.3. Nga analizimi i të dhënave të fashikullit të Komisionit, rezulton se subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e dhëna për pyetësonin standard, lidhur me pyetjen, *nëse gjatë periudhës së deklarimit subjekti ka përdorur ndonjëherë pasuri apo automjete të regjistruara në emër të dikujt tjetër*, si është përgjigjur duke deklaruar se ka përdorur, ndër të tjera, automjetin me targa {***}, për të

udhëtuar në Kosovë, automjet i cili së fundmi ka qenë në pronësi të shtetasit B. D., kushëriri i parë i subjektit.

22.4. Mbi bazën e këtyre të dhënave, Komisioni ka verifikuar marrëdhënien e subjektit me pronarin e këtij automjeti. Konkretisht, rezulton se subjekti ka dhënë shpjegime të detajuara lidhur me marrëdhënien e tij shoqërore me shtetasin A. L., pronar i automjetit me targa {***}, i cili më pas i është shitur shtetasit B. D.

22.5. Nga verifikimi i kryer pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (në vijim AMF), lidhur me këtë automjet, ka rezultuar se:

i) Në datën 29.05.2015, shtetasi A. L. e ka blerë automjetin {***} (vit prodhimi 2003) kundrejt çmimit 450.000 lekë dhe në datën 01.06.2015, ai është pajisur me certifikatën e pronësisë së automjetit. Subjekti edhe në shpjegimet e dhëna për rezultatet e hetimit ka deklaruar se për periudhën 01.06.2015 – 31.05.2016 është prerë policë sigurimi TPL, në të cilën figuron emri i subjektit të rivlerësimit si “përdorues” i automjetit.

ii) Me shkresën nr. {***} prot., datë 09.02.2021, AMF-ja i ka përcjellë Komisionit të dhëna për subjektin e rivlerësimit, sipas së cilave rezulton se ai, Milan Laskaj, më datë 09.06.2017, është pajisur me TPL me nr. serial {***}, e cila ka qenë e vlefshme deri në datën 08.06.2018.

22.6. Trupi gjykues konstaton se argumenti kryesor, mbi të cilin Komisioni ka ndërtuar të gjithë veprimtarinë e tij hetimore rreth kësaj çështje, lidhet me konstatimin se subjekti ka pasur në përdorim automjetin në ditën e dorëzimit të deklaratës *vetting* dhe nuk ka deklaruar në të, këtë të drejtë përdorimi. Bazuar në këtë konstatim, Komisioni ka vijuar me analizën e të gjithë rrethanave të tjera që kanë rezultuar lidhur me këtë pasuri, të cilat e kanë çuar në konkluzionin se ajo është një pasuri e fshehur e subjektit. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi të nisë analizën e tij në funksion të shqyrtimit të pretendimit të subjekti lidhur me këtë pasuri, nga ky konstatim i Komisionit, dhe të vijojë më pas me analizën e të gjithë të dhënave të tjera që kanë rezultuar nga hetimi.

22.6.1. Nga të dhënat e mësipërme, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka disponuar policë sigurimi TPL për automjetin me targa {***}, për dy periudha kohore me kohëzgjatje njëvjeçare secila përkatësisht në periudhën 01.06.2015 – 31.05.2016 dhe 09.06.2017 – 08.06.2018. Nga këto të dhëna të referuara edhe në vendimin e Komisionit, rezulton se në datën 26 janar 2017, kur subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratën *vetting*, ai nuk dispononte një policë sigurimi, në cilën ai të ishte përdorues i këtij automjeti. Ky fakt në vlerësimin e trupit gjykues merr kuptim dhe vlerësohet si jo rastësor, konsideruar se në ushtrim të të drejtave të deleguara subjektit nga pronari i mjetit A. L., nëpërmjet prokurës së posaçme me nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 10.07.2015, subjekti ka shitur automjetin në datën 22.08.2016, te shtetasi B. D., veprim juridik që ndërpret, jo vetëm të drejtat e deleguara me prokurën e posaçme, por edhe ato të përdorimit të mjetit të deleguara nga pronari i vjetër i tij, për sa kohë që nuk ka ende një delegim të drejtash përdorimi nga pronari i ri. Nga sa më sipër, rezulton se në janar 2017, kur subjekti ka plotësuar deklaratën *vetting*, ai nuk ka qenë i pajisur as me prokurë të posaçme të lëshuar nga pronari aktual, B. D. dhe as me policë sigurimi TPL, në të cilën ai të figuronte si përdorues i tij. Kjo situatë faktike është e vetmja për të

cilën duket se ka siguri e që provohet nga analiza e dokumenteve ligjore të përmendur më lart. Në këto kushte, konkluzioni i Komisionit se subjekti duhej të kishte ende të drejta përdorimi mbi automjetin, derisa këtë të drejtë e kishte pasur më parë, nuk rezulton te jetë i mbështetur në situatën faktike që rezulton nga aktet e administruara, por vjen si një vlerësim i Komisionit, bazuar në çmimin që ai i ka bërë të dhënave të rezultuara nga hetimi dhe mosdeklarimi i kësaj të drejte në deklaratat periodike. Në këtë kontekst, duket sporporcionuar barra e provës së ngarkuar subjektit për të provuar mospasjen e një të drejte, e cila nuk figuron të ketë rezultuar nga provat, por nga bindja subjektive e Komisionit, si çdo detyrim negativ për të provuar atë që nuk ekziston.

22.6.2. Për sa referuar më sipër, në kuptim të kërkesave të ligjit nr. 84/2016, të cilat në mënyrë të detajuar janë zbërthyer në kërkesat e deklaratës *vetting*, për sa kohë nuk rezulton ndonjë e dhënë e pasqyruar në dokumentacion ligjor, që subjekti i rivlerësimit gëzonte në kohën e plotësimit të deklaratës *vetting*, të drejtat e përdorimit të automjetit me targa {***}, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit se ai gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë, sipas interpretimin *a contrario* të përcaktimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, është i pabazuar në prova e në ligj.

22.7. Në vijim, trupi gjykues mori në analizë të dhënat e tjera që janë përdorur prej Komisionit për të mbështetur konkluzionin se subjekti ka fshehur të drejtat e pasurisë mbi këtë pasuri. Një prej argumenteve të analizuar prej Komisionit në mbështetje të këtij konkluzion është mënyra e kalimit të pronësisë mbi këtë pasuri te shtetasi A. L. dhe fakti se ai i ka kaluar menjëherë të drejtat e përdorimit mbi këtë automjet te subjekti i rivlerësimit nëpërmjet prokurës së posaçme nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 10.07.2015. Në vlerësimin e kësaj situate, trupi gjykues vëren se ndonëse shpjegimet e subjektit për arsyet që kanë shtyrë pronarin e automjetit A. L. për të deleguar të drejtat e përdorimit të subjekti bashkë me tagrat e tjera që lidhen me disponimin e tij, nuk i japin përgjigje në mënyrë bindëse të gjitha pikëpyetjeve të ngritura prej Komisionit lidhur me këtë sjellje, sërish këto veprime nuk janë të mjaftueshme për të ngritur dyshimet për pasuri të fshehur të subjektit. Në të njëjtën linjë, shkon edhe analiza mbi kryerjen e veprimit juridik të shitjes së kësaj pasurie, nga shitësi A. L. te blerësi B. D., nëpërmjet subjektit në ushtrim të të drejtave të deleguara me prokurën e posaçme. Këto veprime, ndonëse nuk duken të arsyeshme në një kontekst të caktuar të vendosur prej Komisionit, marrin një tjetër natyrë në kontekstin e raporteve të posaçme mes individëve të përfshirë, sipas shpjegimeve të subjektit. Në çdo rast, trupi gjykues i pa këto sjellje jo me peshë përcaktuese, duke pasur në vëmendje kryesisht elemente që lidhen me vlerën e automjetit, vitin e prodhimit, mundësitë financiare për blerjen e tij, në përgjithësi cilësitë fizike dhe vlerat financiare të kësaj pasurie, që e dobëson dyshimin e ngritur prej Komisionit, për fshehjen e kësaj pasurie.

22.8. Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni ka anashkaluar në analizën e tij faktin se subjekti kishte mundësi financiare të blinte këtë pasuri, po ashtu kishin mundësi financiare edhe pronarët *de jure* të tij, si elementë të cilët kanë përcaktuar në jurisprudencën e Kolegjit, por edhe të Komisionit, konkluzionet për pasuri të fshehura, trupi gjykues vlerëson se mungon një analizë e duhur në këtë drejtim. Nga aktet rezulton se pasuria automjet është e modelit, Daimler Chrysler prodhim i vitit 2003, dhe është blerë në vitin 2015 nga shtetasi A. L. në vlerën 4.500 euro. Kjo pasuri i është shitur në vitin 2016 shtetasit B. D. për një vlerë prej 2.500 eurosh. Nga analiza e

kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, në Kolegj, në momentin e kryerjes së këtyre transaksioneve, shtetasit A. L., B. D. dhe vetë subjekti i rivlerësimit kishin burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar secilin prej këtyre transaksioneve. Kjo situatë, ngre pikëpyetje të rëndësishme, lidhur me dyshimin se subjekti i rivlerësimit kishte hyrë në raporte të tilla të dyshimta për të realizuar disponimin faktik të një pasurie, të cilën mund ta gëzonte lehtësisht me të ardhurat e tij. Për më tepër, cilësitë e sendit, në këtë rast automjet, nuk duket se provokojnë të tilla veprime të paligjshme edhe sipas analizës së profilit personal të subjektit të rivlerësimit, i cili, duket se ka jetuar modestish gjatë jetës së tij, duke investuar të gjithë të ardhurat e tij vetëm një apartament për të siguruar jetesën e tij dhe të familjes, ndonëse me një eksperiencë të gjatë në sistem.

22.9. Përveç sa më sipër, trupi gjykues ka në konsideratë jurisprudencën e Kolegjit²⁵ për raste të ngjashme, në të cilat në çdo rast konkluzioni se subjekti ka fshehur pasuritë në pronësi të tij është mbështetur përgjithësisht nga fakti se subjekti apo personat në emër të të cilëve është regjistruar pasuria nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme për ta financuar atë. Kjo analizë nuk rezulton të ketë qenë skematike, por ka buruar gjithmonë nga një arsytim i logjikshëm se subjektet detyrohen të kryejnë një sjellje të tillë, për shkak të pamundësisë për të përballuar me të ardhurat të tyre krijimin e disa pasurive që ata kanë synuar të gëzojnë. Mungesa e kësaj rrethane nuk justifikon, nga vlerësimi i një vëzhguesi të zakonshëm, përfshirjen në sjellje të kundërligjshme që do ta dëmtonin pa kthim karrierën e magjistratit.

22.10. Në përfundim, lidhur me automjetin me targa {***}, i konsideruar nga Komisioni si një pasuri e fshehur e subjektit, trupi gjykues, në analizë të të gjithë të dhënave që rezultojnë nga hetimi, nuk i gjeti ato të mjaftueshme për të konkluduar në të njëjtën mënyrë. Argumente të tilla si: mosprovimi i pasjes prej subjektit të rivlerësimit të një të drejte përdorimi mbi automjetin në kohën e përpilimit të deklaratës *vetting*; pasja e burimeve të ligjshme nga të gjithë personat e përfshirë në transaksionet lidhur me të, prej subjektit të rivlerësimit, po ashtu, vjetërsia dhe vlera e tij, diktuan në mënyrë të rëndësishme konkluzionin se kualifikimi i kësaj shtate me atë të fshehjes së pasurisë nuk do t'i përgjigjej qëllimit të dedikuar për një sjellje të tillë, në kuptim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës. Për pasojë, trupi gjykues e vlerësoi jo të drejtë këtë konkluzion të Komisionit.

- 23.** Në përfundim, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues u ndal në shqyrtimin e pretendimeve të subjektit *me të cilat kërkon rishikimin e analizës tërësore financiare të periudhën 2003-2016*, për të cilat konstaton se:

23.1. Sipas Komisionit, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të evidentuara për vitin 2010 në shumën (-) 171.247 lekë; në vitin 2011 në shumën (-) 1.674.537 lekë; dhe në vitin 2013 në shumën (-) 74.058 lekë.

23.2. Lidhur me këto konkluzione të analizës financiare të Komisionit, trupi gjykues evidenton se në reflektim të konkluzioneve të mësipërme, në vitin 2010, përfshirja në analizën financiare si e ardhur të shumës së marrë hua nga z. P. H., si dhe e dietave të vitit 2009, pasjellin një rezultat

²⁵ *Shih vendimet e Kolegjit (JR) nr. 26/2019; (JR) nr. 9/2020 dhe (JR) nr. 52/2024.*

pozitiv financiar për këtë vit. Po ashtu, edhe për vitin 2010, përfshirja si e ardhur e vlerës së kaparit dhe huaja e marrë nga Z. B., pasjellin që rezultati financiar i këtij vitit të jetë pozitiv. Nga verifikimi i analizës financiare në Kolegj, u konstatua se mbetet i pandryshuar rezultati negativ i analizës për vitin 2013.

23.3. Bazuar në sa më sipër, pas reflektimit në analizën financiare të viteve 2003 – 2016, të konkluzioneve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit rezulton me një balancë financiare negative për vitin 2013 në vlerën prej (-) 74.058 lekësh, e cila po t'i shtohet balancës negative të vitit 2011, që i korrespondon momentit të blerjes së pasurisë apartament, arrin në një total balance negative në vlerën prej (-) 1.205.189 lekësh.

24. Në përfundim të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit, që lidhen më kriterin e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues, këtë situatë së bashku me deklaratimet e pasakta, i vlerësoi nën dritën e parimeve të proporcionalitetit dhe objektivitetit si të pamjaftueshme për të vendosur subjektin në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Në këtë konkluzion, trupi gjykues konsideroi, jo vetëm vlerën e balancës negative të konkluduar, por edhe faktin që ajo i dedikohet krijimit të së vetmes pasuri të krijuar prej subjektit të rivlerësimit, pavarësisht periudhës së gjatë të ushtrimit të funksioneve të prokurorit, në një vlerë dhe zonë modeste. Penalizimi i subjektit, për shkak të kësaj balance negative, do të ishte në vlerësimin e trupit gjykues një konkluzion që do të cenonte të drejtën e individit për jetë private në kuptim të nenit 8 të KEDNJ-së dhe do të cenonte në mënyrë joproporcionale atë edhe përtej qëllimit të sanksionuar në Kushtetutë për kthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe vlerësimin tërësor

25. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionet e Komisionit, lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, duke pretenduar se, *së pari, nuk qëndrojnë gjetjet e Komisionit dhe, së dyti, konstatimet mbi ushtrimin e funksioneve drejtuese nuk mund të jenë objekt vlerësimi, sipas ligjit nr. 84/2016.*

25.1. Në vendimin e Komisionit, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit, pasi janë analizuar të gjitha gjetjet e hetimit administrativ lidhur me këtë kriter, është konkluduar se *subjekti i rivlerësimit ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.* Komisioni, përtej analizimit dhe kontrollit të aftësive profesionale si prokuror, ka marrë në analizë edhe aftësitë e subjektit si Drejtues Prokurorisë Lezhë, ku ai ushtronte funksione drejtuese për periudhën 05.11.2018 - 27.04.2021, Komisioni, pasi ka kontrolluar disa aspekte të ushtrimit të funksioneve drejtuese të subjektit, ka konstatuar se: *(i) ndryshimi i strukturës së Prokurorisë së Rrethit Lezhë (krijimi i një sektori/seksioni të ri) nga subjekti i rivlerësimit ka shkaktuar pamundësinë e funksionimit të sistemit elektronik të ndarjes së çështjeve; (ii) subjekti nuk ka respektuar kërkesat e nenit 21 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, për krijimin e seksionit të ri; (iii) nuk evidentohet asnjë gjurmë e urdhrit që pretendohet se është lëshuar nga subjekti i rivlerësimit për ndryshimin e strukturës së prokurorisë; (iv) është e paqartë se kur është rikuperuar sistemi elektronik dhe nëse subjekti i vlerësimit, në zbatim të detyrave të tij funksionale dhe kompetencave si drejtues i prokurorisë, ka bërë përpjekje për sigurimin e funksionimit të sistemit.*

25.2. Përveç kësaj situate, Komisioni ka konstatuar se subjekti në një procedim penal që nuk ndiqej prej tij, ka nxjerrë dy urdhra për disponimin e provave e materiale të procedimit, duke vlerësuar *se ai ka cenuar pavarësinë e prokurorit të çështjes, në kundërshtim me parashikimet e bëra në nenin 6 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”*. Këto konkluzione janë përdorur prej Komisionit në vlerësimin tërësor që ka bërë për procesin e rivlerësimit të subjektit duke i renditur këto mangësi në shkaqet për të cilat ka konkluduar se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

25.3. Subjekti i rivlerësimit kundërshton analizën e mësipërme të bërë nga Komisioni, duke pretenduar se:

25.3.1. *Analiza që Komisioni ka bërë për veprimtarinë e tij si drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë nuk është e drejtë, pasi është bërë vlerësim i gabuar i provave, situatës faktike e ligjore, duke çuar në konkluzionet e gabuara në vendim se: (a) subjekti ka dështuar në krijimin e një seksioni të ri brenda zyrës së prokurorisë që ai drejtonte, dhe se nuk ka marrë masa lidhur me mosfunksionimin e shortit elektronik; (b) subjekti, duke përpiluar dy urdhra për kthimin e sendeve të sekuestruara të një procedimi penal i cili nuk ndiqej prej tij, ka cenuar pavarësinë e prokurorit të çështjes.*

25.3.2. *Vlerësimi i performancës së punës së tij si Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë duhet të jetë pa ndikim në procesin e tij të rivlerësimit kalimtar, për sa kohë vetë Komisioni ka konkluduar se ai ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuara nga ligji nr. 84/2016.*

25.4. Trupi gjykues vlerëson të sjellë në vëmendje, *së pari*, qëndrimin e tij, të njëjtë me atë të mbajtur edhe në jurisprudencën e Kolegjit²⁶, në raste të tjera të ngjashme se performanca e subjekteve, jo vetëm si magjistratë, por edhe si drejtues, duhet të merret në analizë në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar. Veprimtaria gjyqësore e subjekteve, në raste të caktuara, është ushtruar në terma krejtësisht proceduralë dhe brenda një procesi të caktuar penal apo gjyqësor, por ajo është ushtruar edhe në lëmin e funksioneve drejtuese, kur ato janë kryer prej subjekteve të caktuar. Kjo veprimtari është e kontrollueshme, sipas burimeve të referuara për vlerësimin e aftësive profesionale, nga neni 42, pika 1 e ligjit nr. 84/2016²⁷, që të referon te nenet 79 dhe 80 të ligjit nr. 96/2016, të cilët parashikojnë kriteret të veçanta vlerësimi për kryetarët, që do të thotë se veprimtaria administrative dhe procedurale e kësaj natyre, gjithsesi do të jetë pjesë e vlerësimit të magjistratëve kur ato ushtrojnë këto funksione. Në këto kushte, për sa kohë veprimtaria e subjektit si drejtues prokurorie i mbivendoset aktivitetit të tij si prokuror dhe mund të jetë bërë pjesë e denoncimeve të publikut, trupi gjykues vlerëson se me të drejtë ajo i është nënshtruar analizës nga organet e rivlerësimit kalimtar. Në këtë kuptim, për sa i përket kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale dhe vlerësimit tërësor, pesha që organet e rivlerësimit do t’i japin veprimtarisë së subjektit si drejtues prokurorie në raport me atë si prokuror, mbetet për t’u vlerësuar rast pas rasti, duke konsideruar elementet si: (i) shkeljet e evidentuara edhe nëse ato përfaqësojnë raste të veçanta

²⁶ *Shih vendimet e Kolegjit (JR)15/2021; (JR) 26/2021; (JR)2/2022 dhe (JR)27/2021.*

²⁷ *Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë, si dhe të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët vlerësohen bazuar në burimet e parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve [...].*

apo mënyrë të punës/veprimtarisë si drejtues; (ii) kohëzgjatjen në funksionin si drejtues prokurorie²⁸; apo (iii) pasojat e ardhura nga ndërhyrjet e subjektit në cilësinë e drejtuesit.

25.5. Bazuar në arsyetimin e mësipërm, trupi gjykues, *së pari*, shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit me të cilat kundërshton konstatimet e Komisionit *për veprimtarinë e tij si drejtues prokurorie lidhur me krijimin e seksioneve të reja, si dhe procedurën e ndjekur për shortimin dhe ndarjen e çështjeve*, duke konstatuar dhe analizuar sa vijon.

25.6. Nga analizimi i fashikullit të hetimit administrativ, konstatohet se, lidhur me organizimin e shortit elektronik, si dhe me krijimin e një seksionit të ri të përgjithshëm në zyrën që ai drejtonte duke ndryshuar strukturën e mëparshme dhe duke prishur funksionimin e një seksioni të posaçëm që funksiononte pranë saj, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime me përgjigjet për rezultatet e hetimit kryesisht, të cilat janë të njëjta me ato të parashtruara edhe në ankimin drejtuar Kolegjit.

25.6.1. Nga aktet në dosje rezulton se në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, datë 02.02.2018, lidhur mes Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Brendshëm “*Për krijimin e seksioneve të posaçme*”, Prokuroria e Përgjithshme ka nxjerrë udhëzimin nr. 1, datë 20.02.2018, “*Për Krijimin e Seksioneve të Posaçme*”. Sipas këtij udhëzimi, udhëzohet ngritja e seksioneve të posaçme që do të trajtojnë krimet në fushën e narkotikëve, pastrimit të produkteve të veprës penale, korrupsionit e ato me natyrë financiare, në zyra të caktuara të sistemit të prokurorisë, përfshi edhe Prokurorinë Lezhë. Sipas pikës 1, të Kreut II të këtij udhëzimi, përcaktohet se ushtrimi i kompetencave lëndore të këtyre seksioneve në përbërje të zyrave përkatëse do të ushtrohet nga muaji shkurt 2018 deri në krijimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Posaçme. Ky përcaktim i udhëzimit vjen në përputhje me parashikimin e marrëveshjes së përmendur më lart, sipas dispozitave fundore/kalimtare të së cilës: “*Marrëveshja hyn në fuqi datën e nënshkrimit të saj dhe zbatohet deri në krijimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar*”.

25.6.2. Bazuar në këtë marrëveshje dhe udhëzimit të dalë për zbatimin e saj, ishte krijuar pranë Prokurorisë Lezhë, ky seksion i posaçëm dhe caktimi i prokurorëve në të ishte bërë nga drejtuesi i mëparshëm i zyrës. Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje ndërinstitucionale si dhe Udhëzimi nr. 1, datë 20.02.2018, “*Për Krijimin e Seksioneve të Posaçme*”, duke qenë se në fund të muajit dhjetor 2019 është krijuar dhe ka filluar nga funksionimi Prokuroria e Posaçme, me Urdhrin nr. 1, datë 07.01.2020, “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë*”, subjekti ka shpjeguar²⁹ se ka urdhëruar shkrirjen e seksioneve dhe, për

²⁸ Në rastin objekt analize, nga aktet e hetimit administrativ rezulton se subjekti i rivlerësimit, me urdhrin nr. 243, datë 05.11.2018, të Prokurorit të Përgjithshëm është caktuar përkohësisht si Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, funksion të cilin e ka mbajtur deri më 27.04.2021, kur me vendimin nr. 141, datë 27.04.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë është transferuar Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Nga përmbajtja e urdhrin të caktimit të subjektit në funksionin drejtues i prokurorisë konstatohet se përcaktohet se në këtë funksion është caktuar përkohësisht²⁸, rrethanë e cila duhet mbajtur në konsideratë në vlerësimin e ushtrimit të rolit të tij si drejtues.

²⁹ Nga aktet e fashikullit të hetimit administrativ, rezulton se subjekti bashkëlidhur shpjegimeve të dhëna për rezultatet e hetimit administrativ ka përcjellë në Komision edhe aktet: (i) kopje e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrisë së Brendshme; (ii) kopje të Udhëzimit nr. 1, datë 20.02.2018, i

rrjedhojë, kjo zyrë prokurorie është organizuar në një seksion të vetëm të përgjithshëm, për shkak të numrit të ulët të prokurorëve, pasi për çdo seksion duhet të kishte të paktën tre prokurorë, ndërsa zyra kishte 5 (pesë) prokurorë, duke përjashtuar drejtuesin.

25.6.3. Në përmbajtjen e këtij urdhri arsyetohet se vendimi për shkrirjen e seksioneve është marrë për shkak se: (i) Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë ka në përbërje 5 (pesë) prokurorë (përjashtuar drejtuesin), i cili është një numër i vogël për t'u ndarë në seksione; (ii) sipas të dhënave të vitit të mëparshëm 2019, numri i veprave penale që duhet të ndiqen nga seksioni i posaçëm i përkohshëm është në përpjesëtim të zhdrejtë me numrin e veprave dhe procedimeve penale që duhet të ndiqen nga seksioni tjetër; (iii) marrëveshja e bashkëpunimit, datë 02.02.2018, ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Brendshëm “Për krijimin e seksioneve të posaçme”, ka qenë në fuqi deri në datën e krijimit të SPAK-ut, i cili, më datë 19.12.2019, është krijuar dhe ka nisur të funksionojë.

25.6.4. Nisur nga këto të dhëna, trupi gjykues konstaton, *së pari*, se qëndrimi i Komisionit se *nuk evidentohet asnjë gjurmë e urdhrit që pretendohet se është lëshuar nga subjekti i rivlerësimit për ndryshimin e strukturës së Prokurorisë*, nuk qëndron, pasi urdhri nr. 1, datë 07.01.2020, i lëshuar nga subjekti i rivlerësimit, rezulton të jetë paraqitur si provë prej tij së bashku me shpjegimet për rezultatet e hetimit administrativ. Nga ana tjetër, rezulton se nëpërmjet këtij urdhri, subjekti në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë ka marrë vendime për organizimin e saj, të cilat janë arsyetuar dhe referuar se ku bazohen. Gjithashtu, edhe për sa i përket përmbajtjes, rezulton se urdhri nr. 1, datë 07.01.2020, ka tiparet e një akti që vjen në harmoni me marrëveshjen e bashkëpunimit, e cila më parë kishte paracaktuar krijimin e seksioneve të posaçme për hetimin e disa veprave penale derisa të krijohet Prokuroria e Posaçme dhe, për më tepër, duket se është nxjerrë për mirorganizimin e punës, duke synuar që të gjithë prokurorët e zyrës të kenë ngarkesë të barabartë pune, në konsideratë edhe të faktit se ndarja në seksione sipas të dhënave statistikore nuk e lejonte një gjë të tillë. Në këtë kuptim, trupi gjykues konstaton se nxjerra e këtij urdhri ka qenë në përputhje dhe ushtrimin e kompetencave drejtuese të subjektit, dhe e kundërta do të përfaqësonte një administrim jo të duhur të zyrës, pasi nëse do të vijonte të ekzistonte një seksion i posaçëm, i cili do të mbetej pa lëndë për shkak se Prokuroria e Posaçme që kishte filluar funksionimin kishte thithur të gjitha veprat në kompetencë të tij, prokurorët e këtij seksioni do të zbalancoheshin në ngarkesë në raport me prokurorët e tjerë të zyrës dhe kjo do të krijonte keqfunksionim të saj. Për pasojë, trupi gjykues nuk e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit lidhur me këtë çështje.

25.7. Lidhur me konkluzionin e Komisionit se kjo formë organizimi *ka shkaktuar pamundësinë e funksionimit të sistemit elektronik të ndarjes së çështjeve*, trupi gjykues analizoi korrespondencën e administruar nga Komisioni mes subjektit dhe Prokurorisë së Përgjithshme, nëpërmjet komunikimeve me *e-mail* brenda së njëjtës dite me nxjerrjen e urdhrit të mësipërm, datës 07.01.2020³⁰. Sipas këtij komunikimi, specialistët e institucionit, pasi e kanë administruar këtë

Prokurorisë së Përgjithshme; si dhe (iii) kopje të Urdhrit nr. 1, datë 07.01.2020, të Drejtuesit të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë.

³⁰ *Me e-mail-in e datës 07.01.2020, punonjësi i Prokurorisë Lezhë z. A. D., njofton përfaqësuesit e Prokurorisë së Përgjithshme se, më datë 07.01.2020, drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, ka vendosur shkrirjen e seksioneve duke i renditur prokurorët në një seksion të vetëm.*

njoftim, kanë konstatuar vështirësi në organizimin e shortit elektronik për shkak të strukturës së re të organizimit të zyrës, i cili, pas ndërhyrjeve teknike, rezultoi se ka rifilluar të funksionojë më datë 14.01.2020. Nga Komisioni, rezultoi se janë administruar të dhëna që dëshmojnë për mbajtjen e procesverbaleve për hedhjen e shortit manual për çdo kallëzim të administruar gjatë kohës që nuk ka funksionuar shorti elektronik nga 07.01.2020 deri në 14.01.2020.

25.7.1. Nga faktet e mësipërme, trupi gjykues konstaton se nuk është i drejtë konkluzioni i Komisionit se për shkak të administrimit jo në mënyrën e duhur prej subjektit është bërë i pamundur hedhja e shortit elektronik për ndarjen e çështjeve. *Së pari*, siç u arsyetua më lart, subjekti ka nxjerrë urdhrin nr. 1, datë 07.01.2020, për shkrirjen e seksionit të posaçëm në ushtrim të kompetencave të tij drejtuese e bazuar në aktet normative të Prokurorit të Përgjithshëm. *Së dyti*, ka njoftuar brenda të njëjtës ditë, do të thotë pa vonesë, Drejtorinë e Teknologjisë dhe Informacionit në Prokurorinë e Përgjithshme, si struktura përgjegjëse për situatën e re të krijuar e që kishte lindur nevojën për ndërhyrje teknike në sistem, në mënyrë që të mos kishte pengesa në administrimin e informacionit nëpërmjet sistemit elektronik të shortimit të materialeve kallëzuese CAMS. Për shkak të kësaj ndërhyrje të detyruar, rezultoi se zyra ka vijuar me shortimin manual vetëm për 7 (shtatë) ditë dhe asnjë problematikë nuk evidentohet të jetë shkaktuar lidhur me këtë mënyrë të ndarjes së çështjeve në këtë periudhë.

25.8. Për sa më lart, trupi gjykues, lidhur me nxjerrjen e urdhrin nr. 1, datë 07.01.2020, për shkrirjen e seksionit të posaçëm në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, konstatoi se ai ishte diktuar kryesisht nga mbarimi i afatit të ngritjes së këtij seksioni, sipas përcaktimit të udhëzimit nr. 1, datë 20.02.2018, të Prokurorit të Përgjithshëm, afat i cili lidhej me ngritjen dhe funksionimin e Prokurorisë së Posaçme, e cila kishte filluar ushtrimin e funksioneve në muajin dhjetor 2019 dhe problematikat e krijuara me aplikimin e shortit manual në vend të atij elektronik për një kohë të shkurtër nuk u vlerësuan se kishin prodhuar një ndikim domethënës në performancën e veprimtarisë së institucionit.

25.9. Lidhur me problematikën tjetër të konstatuar prej Komisionit në këndvështrim të ushtrimit të funksioneve drejtuese të subjektit, pasi *duke përpiluar dy urdhra³¹ për kthimin e sendeve të sekuestruara të procedimit penal nr. {***/2020, i cili nuk ndiqej prej tij, subjekti ka cenuar pavarësinë e prokurorit të çështjes*, trupi gjykues konstaton dhe analizon sa vijon.

25.9.1. Nga shqyrtimi i akteve të administruara në fashikullin e Komisionit rezultoi se:

i) Më datë 05.01.2020, nga shërbimet e Policisë Rrugore pranë Drejtorisë Vendore Policisë Lezhë, (në vijim DVP Lezhë) është bërë kapja në flagrancë e shtetasit E. N., duke drejtuar një automjet pa qenë i pajisur me leje drejtimi, për shkak të konsumimit të elementeve të veprës penale “Drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt” të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal dhe është mbajtur edhe procesverbal i sekuestrimit të provës materiale përkatësisht i automjetit tip “BMW”, me targa {***}, së bashku me dokumentet përkatëse.

³¹ Aktet evidentojnë se kemi të bëjmë vetëm me një urdhër të nxjerrë nga subjekti, pasi akti tjetër është shkresa përcjellëse që po subjekti, si kryesues i prokurorisë, ia ka përcjellë për zbatim Policisë së Shtetit. (shih shpjegimin e relacionit në paragrafin vijues 7.6, pika iv).

ii) Mbi bazën e informacionet të mësipërm, më datë 16.01.2020, prokurore R. F., e Prokurorisë pranë Gjykatës të Rrethi Gjyqësor Lezhë, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. {***}, në ngarkim të shtetasit E. N., për veprën penale “Drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt” të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

iii) Më datë 15.01.2020, shtetasi E. D. i drejton një kërkesë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në vëmendje prokurores R. F., me anë të së cilës i kërkon kthimin e automjetit të sekuestruar.

iv) Më datë 17.01.2020, subjekti i rivlerësimit Milan Laskaj ka nxjerrë urdhrin “*Për kthimin e sendit të sekuestruar*”, me anë të të cilit ka urdhëruar kthimin e menjëhershëm të automjetit shtetasit E. N., në mbështetje të nenit 218/3 të Kodit Procedurës Penale, meqenëse *nuk paraqet interes të mëtejshëm për hetim*. Në të njëjtën datë, më 17.01.2020, subjekti i rivlerësimit ka nxjerrë edhe urdhrin “*Për kthimin e dokumenteve*”, që i përkisnin të automjetit të mësipërm.

v) Nga aktet rezulton se me vendimin nr. {***}, datë 18.06.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, mbi bazën e kërkesës për gjykim të prokurorisë pranë kësaj gjykate, ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurit E. N., për veprën penale “Drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt” të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, duke e dënuar atë me 30 ditë burgim, dënim i cili, në aplikim të nenit 51 dhe nenit 63 të Kodit Penal, si dhe të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, është konvertuar në punë në interes publik pashpërblim.

25.9.2. Subjekti ka shpjeguar se nënshkrimi prej tij i urdhrave të datës 17.01.2020 është bërë jo në cilësinë si drejtues prokurorie, por si prokuror/koleg, për t’i ardhur në ndihmë prokurores së çështjes R. F., e cila atë ditë nuk ishte paraqitur në punë dhe do të mungonte edhe në ditët në vijim³², e cila i ka kërkuar subjektit ta nënshkruaj ai këtë urdhër të hartuar paraprakisht prej saj. Në ankim, subjekti evidenton se si prokuror, jo pak herë, ka zëvendësuar kolegët dhe anasjelltas në seancat gjyqësore kur prokurori i çështjes e ka pasur të pamundur të paraqitet, dhe se në asnjë rast kjo praktikë nuk është konsideruar si ndërhyrje në pavarësinë apo punën së tij si prokuror. Subjekti kërkon të mbahet në konsideratë se: (i) urdhrat për kthimin e automjetit të sekuestruar dhe të dokumenteve të tij nuk janë veprime që vijnë në kundërshtim me ndonjë dispozitë ligjore, duke pretenduar se me anë të tyre është synuar rivendosja e një të drejtë të cenuar një shtetasi tjetër, z. I. B., i cili ishte pronari legjitim i automjetit dhe nuk kishte lidhje me veprën penale; dhe se (ii) mbajtja e automjetit të sekuestruar nuk i shërbente hetimit. Subjekti shpjegon se kthimi i sendit të sekuestruar, në kuptim të nenit 190 të Kodit të Procedurës Penale, përbën një disponim të prokurorit në fazën e hetimeve paraprake, gjatë apo në përfundim të tyre, kur ato nuk i shërbejnë hetimit dhe, në këto kushte, nuk mund të pretendohet për ndërhyrje në punën e prokurores R. F., e cila nëse do të ishte prezent atë ditë do t’i kishte nënshkruar vetë këto urdhra. Subjekti evidenton se Komisioni në mënyrë të padrejtë nuk ka konsideruar deklaratimet e bëra nga prokurorja R. F. në deklaratën noteriale të datës 19.03. 2024, në të cilën deklaroi se: “*Urdhrrat për kthimin e automjetit janë nxjerrë me miratimin e saj, e thënë ndryshe për të formalizuar një vullnet të shprehur qartë*

³² Sipas shkresën nr. {***} prot., datë 26.03.2024, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, jepet informacioni për daljen jashtë vendit të prokurores R. F., ditën e hënë, më datë 21.01.2020.

nga prokurore R. F., por për shkak të mosnënshkrimit të tyre, për arsye harrese, nuk mund të dërgoheshin në DV Policisë Lezhë”.

25.9.3. Trupi gjykues, duke vlerësuar situatën e mësipërme, fillimisht konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë qenë i pajisur me ndonjë akt që të legjitimonte veprimtarinë e tij si prokuror i një çështje që nuk trajtohej prej tij. Dispozitat e Kodit të Procedurës Penale parashikojnë pavarësinë e prokurorit të çështjes dhe kompetencën e tij lëndore për të marrë çdo vendim brenda nevojës së ushtrimit të ndjekjes penale në një çështje të caktuar. Sipas neneve 27 e vijues të këtij kodi, vetëm nëpërmjet institutit të zëvendësimit, mundet një prokuror të ndërmarrë veprime hetimore në një çështje që është duke u ndjekur nga një prokuror tjetër. Pavarësisht këtyre konsideratave, trupi gjykues, në rastin konkret, vlerësoi sjelljen e subjektit në raport me dy të dhëna të rëndësishme: *së pari*, urdhrat duket se janë autorizuar të nxirren prej prokurores së çështjes, sipas miratimit të saj të shprehur në deklaratën noteriale nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 19.03.2024, por edhe mungesës së reagimit negativ ndaj nxjerrjes së tyre; *së dyti*, kjo situatë ka ndodhur për shkak të disa rrethanave që lidheshim me mosprezencës e saj në detyrë, jo si një vijë sjellje e subjektit dhe, *së treti*, duket se disponimet e kryera kanë ardhur në përputhje me parashikimet ligjore dhe kanë shërbyer për moscenimin e mëtejshëm të të drejtave të individëve që, për më tepër, nuk ishin të përfshirë në kryerjen e veprës penale, për të cilën zhvilloheshin hetimet. Në këtë kuptim, konkluzioni i Komisionit se subjekti me këtë sjellje ka cenuar pavarësinë e prokurores së çështjes, vlerësohet si jo objektiv, për sa kokë që asnjë gjurmë i këtij perceptimi nuk gjendet në retorikën e vetë prokurores së çështjes rreth rastit.

25.9.4. Bazuar në sa analizuar më sipër, në vlerësimin e trupit gjykues, pesha e mangësisë që lidhet me mungesën e formalizimit të tagrave të ushtruara prej subjektit, në vend të prokurores së çështjes, nuk mund të ketë një peshë përcaktuese në vlerësimin e punës së subjektit si drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatë së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

25.9.5. Në përfundim, trupi gjykues, lidhur me nxjerrjen prej subjektit të dy urdhrave për kthim dokumentacioni dhe një automjeti të sekuestruar, ndërsa çështja penale ndiqej nga një prokurore tjetër, ndonëse konstatoi se kjo veprimtari nuk ishte e formalizuar në drejtim të pasjes së tagrave ligjore për marrjen e urdhrave të tillë, konsideruar rrethanat e çështjes dhe qëndrimin e mbajtur prej vetë prokurores që ndiqte hetimin, nuk e vlerësoi atë në nivelin e cenimit të pavarësisë së prokurorit.

26. Në këto kushte, në mungesë të konkluzionit për fshehje të pasurisë, i përdorur si argument për vlerësimin tërësor nga Komisioni, si edhe qëndrimin të mbajtur për dy çështjet e trajtuara, lidhur me funksionet drejtuese të subjektit, trupi gjykues konstatoi se kjo alternativë e vlerësimit të procesit të rivlerësimit mbeti pa lëndën në të cilën ishte bërë ky vlerësim. Për pasojë, trupi gjykues arriti në konkluzionin se aplikimi i nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, prej Komisionit, është i gabuar.
27. Për sa më lart, në kushtet kur subjekti ka rezultuar me një nivel të besueshëm në kriterin e kontrollit të figurës dhe ka arritur një nivel kualifikues në kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, trupi gjykues vlerësoi se vendimi i Komisionit, për shkarkimin e tij nga detyra, duhet të ndryshohet.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 748, datë 27.03.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Milan Laskaj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 01.10.2025.

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi